


INDEKSI I TRANSPARENCËS SË KOMUNAVE MALAZEZE







INDEKSI
I TRANSPARENCËS
SË KOMUNAVE
MALAZEZE

Podgoricë, 2020

INDEKSI I TRANSPARENCËS SË KOMUNAVE MALAZEZE

Botues:

Qendra për Arsimim Qytetarë (QAQ)

Redaktore:

Daliborka Ulareviq

Autorja kryesore:

Mira Popoviq

Koautorët:

Maja Marinoviq

Ana Neneziq

Bashkëpunëtorë në hulumtim:

Vasilije Raduloviq

Dizajni dhe produksioni:

Qendra për Arsimim Qytetarë (QAQ)

Përktheu në gjuhën shqipe:

Admir Gjoni

Shtypur në:

Studio Mouse



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



Zadruqa

Raporti është pjesë e projektit "Ta vendosim korrupsionin në muze!" të cilin e realizon Qendra për Arsimim Qytetarë (QAQ) në partneritet me OJQ "Qendra për Monitorim dhe Hulumtim"(QMH), OJQ Bonum nga Plevla, OJQ UL-info nga Ulqini dhe OJQ Za druga nga Petrovaci, në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa financohet nga Bashkimi Evropian me bashkëfinancimin e Ministrisë së Administratës Publike.



Projektin e financojnë
Bashkimi Evropian

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e QAQ-së dhe QMH-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si qëndrim zyrtarë i Bashkimit Evropian ose i Ministrisë së Administratës Publike.



QEVERIA E MALIT TË ZI
MINISTRIA E
ADMINISTRATËS PUBLIKE

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----|
| Hyrje | 6 |
| Metodologjia | 7 |
| Vlerësimi i përgjithshëm i transparencës së komunave në Mal të Zi | 11 |
| Sa janë transparente komunat malazeze? | 16 |
| • Andrijevicë | 17 |
| • Tivar | 20 |
| • Beranë | 23 |
| • Bijello Pole | 26 |
| • Budvë | 29 |
| • Cetinë | 32 |
| • Danillovgrad | 35 |
| • Gollubovci | 38 |
| • Guci | 41 |
| • Herceg Novi | 44 |
| • Kollashin | 47 |
| • Kotorr | 50 |
| • Mojkovac | 53 |
| • Nikshiq | 56 |
| • Petnicë | 59 |
| • Plavë | 62 |
| • Plevlë | 65 |
| • Plluzhinë | 68 |
| • Podgoricë | 71 |
| • Rozhajë | 74 |
| • Shavnik | 77 |
| • Tivat | 80 |
| • Tuz | 83 |
| • Ulqin | 86 |
| • Zhabjak | 89 |
| Hulumtimi | 92 |
| Vërejtjet përfundimtare | 101 |

HYRJJE

Eliminimi i korrupsionit kërkon qasje multidisiplinare, të vazhdueshme dhe shtresore, e një nga parakushtet është edhe shkalla e lartë e transparencës në punën e organeve të sektorit publik. Vetëqeverisjet vendore janë shërbimi më i afërt i qytetarëve dhe qytetareve prej të cilit pritet që t'i përgjigjet nevojave të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Mirëpo, transparenca vazhdon të mos jetë pjesë përbërëse e punës së tyre që kjo mungesë ia vështirëson, konsiderueshëm, procedurat e ndryshme qytetarëve dhe qytetareve, por edhe mbikëqyrjen e politikave publike nga ana e shoqërisë civile. Po ashtu, në këtë mënyrë nuk kontribuohet as në eliminimin e formave dhe praktikave joetike dhe korruptive.

Transparenca e komunave malazeze mund të nxitet edhe me monitorimin i cili si rezultat ka gjendjen vjetore. *Indeksi i Transparencës së Komunave Malazeze* jep kontributin e drejtpërdrejtë në këtë drejtim duke sistematizuar dhe kornizuar, në aspektin metodologjik, aktivitetet e mëhershme në këtë lëmi.

Monitorimi shumëvjeçar i faqeve të internetit të komunave, të cilët duhen të jenë mënyra më e thjeshtë e informimit mbi punën e tyre, tregon se komunat malazeze kanë bërë një hap përpara. Domethënë, sot këto faqe janë më të mira nga ana vizuale, më funksionale dhe më me përmbajtje sesa në periudhën para disa vitesh. Por, ato vazhdojnë të mos ofrojnë sasinë e mjaftueshme të informatave dhe dokumenteve, si të atyre që janë obligim ligjor i komunave, ashtu edhe të atyre që duhet të publikohen në mënyrë proaktive. *Indeksi i Transparencës së Komunave Malazeze* jep një pasqyrim të gjendjes momentale me shpjegimet e hollësishme të cilët mund të konsiderohen si udhëzime për çdo komunë.

Po ashtu, *Indeksi i Transparencës së Komunave Malazeze* prezanton edhe rezultatet e hulumtimit të opinionit publik i cili ka të bëjë me perceptimin e qytetarëve dhe qytetareve për korrupsionin në Mal të Zi.

Indeksi i Transparencës së Komunave Malazeze u krijua në kuadër të projektit "Ta vendosim korrupsionin në muze", të cilin e realizon Qendra për Arsimim Qytetarë (QAQ) me organizatat joqeveritare QMH nga Podgorica, "Za Druga" nga Petrovac, Bonum nga Plevla dhe UL-info nga Ulqini, në bashkëpunim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ministrinë e Administratës Publike. Shpresojmë se në matjet e ardhshme vjetore komunat malazeze do të arrijnë rezultate shumë më të mira sa i përket transparencës, e si rrjedhojë të kontribuojnë kështu edhe në arkivimin e korrupsionit në shoqërinë tonë.

METODOLOGJIA

Për nevojat e hulumtimit, i cili në fokus kishte vlerësimin e shkallës së transparencës së komunave në Mal të Zi, skuadra hulumtuese e Qendrës për Arsimim Qytetarë (QAQ) bëri analizën e hollësishme të faqeve zyrtare të internetit të të gjithë komunave, e në pajtim me kornizën metodologjike të përgatitur paraprakisht, e cila kishte synim kontrollin e publikimit të informatave dhe dokumenteve me rëndësi publike.

Kjo analizë është bërë gjatë janarit dhe shkurtit të vitit 2020, duke theksuar se kontrollet plotësuese të disa pikave¹ janë kryer gjatë marsit të vitit 2020. Në bazë të kësaj, *Indeksi i Transparencës së Komunave Malazeze* për vitin 2020 përfshinë të dhënat të cilat gjendeshin në faqet e internetit të komunave deri në periudhën e përmendur kur hulumtuesit kanë kontrolluar publikimin e dokumenteve/informatave, e që do të thotë se ekziston mundësia e devijimeve nëse informatat/dokumentet u publikuan më vonë ose kanë ndryshuar faqet e komunave.

Informatat e kërkuara me rëndësi publike janë grupuar në gjashtë fusha tematike: *Kuvendi i Komunës, buxheti, lufta kundër korrupsionit, qasshmëria e informatave të përgjithshme, prokurimet publike, shqyrtimet publike dhe konkurset publike.*

Çdo fushë e përmendur përbënte një sërë pyetjesh të cilat korrespondonin me nevojat e vërejtura të qytetarëve dhe qytetareve, por edhe me nevojat e organizatave të shoqërisë civile me qëllim kontrollin e suksesshëm të politikave publike në nivel vendor dhe shfrytëzimin e shërbimeve të administratave lokale. Po ashtu, bëhet fjalë për informatat/dokumentet të cilët janë të përcaktuara me një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore dhe si të tillë duhet të jenë lehtësisht të qasshme.

Regjistri i përgjithshëm përfshiu 61 pyetje me 100 pikë maksimale. Duhet theksuar se pyetjet kishin numër të ndryshëm të pikëve, prej 1 deri në 2 për informatën/dokumentin që ekziston, e nëse kishte informata/dokumente gjysmake skuadra hulumtuese ndau numrin e pikëve në varësi të asaj se sa informata/dokumente mungojnë, gjersa 0 pikë janë dhënë aty ku nuk kishte asnjëfarë informatash/dokumentesh të kërkuara për fushën e caktuar.

Pjesa e cila kishte të bënte me **Kuvendin e Komunës** përfshiu punën dhe rezultatet e dokumentuara të këtij organi dhe atë përmes 10 pyetjesh të cilat kishin 15 pikë maksimale.

| Nr. rend. | Informatat/dokumentet e kërkuara | Nr. i pikëve |
|-----------|---|--------------|
| 1. | A janë të publikuara në faqen e internetit vendimet të cilët i miratoi Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019? | 2 |
| 2. | A janë të publikuara në faqen e internetit rezultatet e votimit në seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019? | 1 |
| 3. | A janë të publikuara në faqen e internetit votat individuale të këshilltarëve gjatë vitit 2019? | 1 |

¹ U kontrollua shtesë se a e dorëzuan kryetarët e Komunave raportin e pasurisë për vitin 2019 pranë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe a u publikuan raportet e punës së Komunave për vitin 2019 dhe llogaritë përfundimtare për vitin 2019.

| | | |
|-----|---|----------------|
| 4. | A janë të publikuara në faqen e internetit amendamentet e dorëzuara në propozim aktet e shqyrtuara në seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019? | 2 |
| 5. | A janë të publikuara në faqen e internetit arsyetimet e amendamenteve të dorëzuara në propozim aktet e shqyrtuara në seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019? | 1 |
| 6. | A është i publikuar në faqen e internetit rendi i ditës i seancës së ardhshme plenare të Kuvendit të Komunës? | 2 |
| 7. | A është e publikuar në faqen e internetit lista e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës? | 2 |
| 8. | A ekzistojnë në faqen e internetit kontaktet individuale të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës (nr. i telefonit, e-mail)? | 2 |
| 9. | A publikohen procesverbalet e hollësishme (transkriptët) nga seancat plenare të Kuvendit të Komunës? | 1 |
| 10. | A transmetohen drejtpërdrejtë në media seancat plenare të Kuvendit të Komunës? | 1 ² |

Fusha e dytë përshiu informata dhe dokumentet themelore të cilët kanë të bëjnë me **buxhetimin dhe raportimin për buxhetin** përmes 10 pyetjeve me 16 pikë maksimale.

| Nr. rend. | Informatat/dokumentet e kërkuara | Nr. i pikëve |
|-----------|--|--------------|
| 1. | A është i publikuar në faqen e internetit Buxheti i vitit 2019? | 2 |
| 2. | A është i publikuar në faqen e internetit arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019? | 1 |
| 3. | A është i publikuar në faqen e internetit Buxheti i vitit 2019 në formatin e lexueshëm (në formatin. xls ose .xlsx)? | 2 |
| 4. | A janë të publikuara në faqen e internetit raportet për realizimin e Buxhetit të vitit 2019? | 2 |
| 5. | A është i publikuar në faqen e internetit Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët dhe Qytetaret? | 1 |
| 6. | A është e publikuar në faqen e internetit thirrja publike për shqyrtimin publik të Buxhetit të vitit 2019? | 1 |
| 7. | A u mbajt shqyrtimi publik për Buxhetin e vitit 2019? | 2 |
| 8. | A është publikuar në faqen e internetit Raporti i Shqyrtimit Publik për Buxhetin e Vitit 2019? | 2 |
| 9. | A u shqyrtua Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të Vitit 2019? | 2 |
| 10. | A u publikua në faqen e internetit Buxheti i vitit 2020? | 1 |

Në fushën e **luftës kundër korrupsionit** përmes 13 pyetjeve, që kishin 23 pikë maksimale, u verifikua qasshmëria e informatave me rëndësi për parandalimin dhe eliminimin e akteve korruptive në nivel vendor.

| Nr. rend. | Informatat/dokumentet e kërkuara | Nr. i pikëve |
|-----------|---|----------------|
| 1. | A u publikuan në faqen e internetit informatat mbi mekanizmat e denoncimit të korrupsionit? | 2 |
| 2. | A u publikua në faqen e internetit opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë në punë, gjegjësisht shkeljet e ligjit? | 2 |
| 3. | A mundësojnë mekanizmat ekzistues denoncimin e korrupsionit dhe parregullsive në mënyrë anonime? | 1 |
| 4. | A është i publikuar në faqen e internetit raporti ose informata mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të procedura gjatë vitit 2019? | 2 |
| 5. | A është i publikuar në faqen e internetit Kodeksi Etik për të punësuarit? | 2 |
| 6. | A u miratua Plani i Integritetit për periudhën 2018-2020? | 2 |
| 7. | A u miratua Raporti mbi Zbatimin e Planit të Integritetit 2019-2020? | 2 |
| 8. | A u miratua Plani Lokal i Antikorrupsionit për vitin 2019? | 2 |
| 9. | A u miratua Raporti mbi realizimin e Planit Lokal të Antikorrupsionit për vitin 2019? | 2 |
| 10. | A u publikuan në faqen e internetit informatat mbi pagat e funksionarëve? | 1 |
| 11. | A u publikuan në faqen e internetit informatat mbi pagat e zyrtarëve? | 1 |
| 12. | A ekziston kontakti i personit të emëruar për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve? | 2 |
| 13. | A e dorëzoi kryetari i Komunës raportin e pasurisë për vitin 2019? | 2 ³ |

Pjesa rreth **qasshmërisë së informatave të përgjithshme** përfshiu 15 pyetje, me 25 pikë maksimale, e të cilat kishin të bënin me transparencën e përgjithshme të punës së komunave dhe qasshmërinë e informatave për shërbimet bazike.

| Nr. rend. | Informatat/dokumentet e kërkuara | Nr. i pikëve |
|-----------|---|----------------|
| 1. | A është i publikuar në faqen e internetit orari i punës i vetëqeverisjes vendore? | 2 |
| 2. | A është i publikuar në faqen e internetit lista e inspektorateve të Komunës? | 2 |
| 3. | A janë të publikuara në faqen e internetit veprimet sipas ankesave dhe vërejtjeve? | 2 |
| 4. | A janë të publikuara në faqen e internetit të dhënat kontaktuese të kryetarëve të bashkësive lokale? | 2 |
| 5. | A janë të publikuara të dhënat kontaktuese të kryetarit/kryetares së Komunës? | 2 |
| 6. | A është i përcaktuar orari i pranimit të qytetarëve tek kryetari/kryetarja e Komunës? | 1 |
| 7. | A është e publikuar në faqen e internetit Rregullorja për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës? | 1 ⁴ |
| 8. | A është i publikuar në faqen e internetit Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës? | 2 |
| 9. | A është i publikuar në faqen e internetit Plani Vjetor i Punës së vetëqeverisjeve vendore? | 1 |
| 10. | A është i publikuar në faqen e internetit Raporti i Punës i vetëqeverisjes vendore për vitin 2019? | 2 |
| 11. | A janë të publikuara në faqen e internetit të dhënat mbi numrin e të punësuarve në Komunë? | 1 ⁵ |
| 12. | A janë të publikuara në faqen e internetit të dhënat mbi numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike? | 1 ⁶ |
| 13. | A është i publikuar në faqen e internetit Udhëzuesi për Qasjen e Lirë të Informatave? | 2 |
| 14. | A është e publikuar në faqen e internetit pasqyra e informatave të lejuara sipas Ligjit për Qasjen e Lirë të Informatave? | 2 |
| 15. | A është i publikuar kontakti i personit që merr vendimet në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata? | 2 ⁷ |

Prokurimet publike janë një nga fushat më të ndjeshme që kërkon edhe shkallën e theksuar të transparencës dhe kontrollit, prandaj edhe kjo pjesë u adresua përmes gjashtë pyetjeve me 11 pikë maksimale.

| Nr. rend. | Informatat/dokumentet e kërkuara | Nr. i pikëve |
|-----------|--|--------------|
| 1. | A ekziston në faqen e internetit seksioni i dedikuar për prokurimet publike? | 1 |
| 2. | A janë të publikuara në faqen e internetit të dhënat mbi konkurset për prokurimet publike? | 2 |
| 3. | A janë të publikuara në faqen e internetit të dhënat për ofertuesin e përzgjedhur? | 2 |
| 4. | A janë të publikuara në faqen e internetit të dhënat për prokurimet publike të realizuara gjatë vitit 2019? | 2 |
| 5. | A është i publikuar në faqen e internetit Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019? | 2 |
| 6. | A është i publikuar në faqen e internetit Raporti mbi Zbatimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019? | 2 |

Në fund, u trajtua edhe fusha **shqyrtimet publike dhe konkurset publike** përmes shtatë pyetjesh që kishin 10 pikë maksimale.

3 Skuadra hulumtuese ka kërkuar dokumentin unik i cili përfshinë të gjithë organet, e jo veç e veç sipas organeve

4 U kërkuua regjistri i hollësishëm, e jo emrat e numruar të të punësuarve në kuadër të organeve

5 U kërkuua regjistri i hollësishëm, e jo emrat e numëruar të të punësuarëve në kuadrë të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve

6 Skuadra hulumtuese llogariti se ekziston personi i kontaktit nëse ai është i caktuar në Udhëzuesin për Qasjen e Lirë të Informatave ose në faqen e internetit në pjesën e kontakteve


| Nr. rend. | Informatat/dokumentet e kërkuara | Nr. i pikëve |
|-----------|--|--------------|
| 1. | <i>A janë të publikuara në faqen e internetit të dhënat për shqyrtimet publike të mbajtura gjatë vitit 2019 (përveç buxhetit)?</i> | 2 |
| 2. | <i>A përmbajnë raportet për shqyrtimet publike propozimet e subjekteve të interesuara?</i> | 2 |
| 3. | <i>A përmbajnë raportet për shqyrtimet publike arsyet për pranimin/refuzimin e propozimeve të subjekteve të interesuara?</i> | 2 |
| 4. | <i>A janë të publikuara në faqen e internetit konkurset për ndajren e mjeteve mediave gjatë vitit 2019?</i> | 1 |
| 5. | <i>A janë të publikuara në faqen e internetit rezultatet e konkurseve, mbi çfarëdo baze, që janë të dedikuara për media?</i> | 1 |
| 6. | <i>A janë të publikuara në faqen e internetit konkurset për ndarjen e mjeteve OJQ-ve gjatë vitit 2019?</i> | 1 |
| 7. | <i>A janë të publikuara në faqen e internetit rezultatet e konkursit për ndarjen e mjeteve OJQ-ve gjatë vitit 2019?</i> | 1 |

Me këtë hulumtim janë përfshirë 24 komuna dhe Komuna Urbane e Gollubovcit dhe të gjithë faqet e tyre zyrtare të internetit në periudhën e realizimit të hulumtimit, e të cilat janë kontrolluar dhe vlerësuar në bazë të informatave/dokumenteve të cilat asokohe ishin pjesë e përmbajtjes së tyre. Duhet theksuar se këto faqe janë kryesisht të kënaqshme nga ana vizuale, por në shumë raste vlera e tyre përdoruese është e diskutueshme.

Hulumtuesit shpesh nuk e kishin të lehtë gjetjen e disa dokumenteve themelore në faqe të internetit ose ishte i nevojshëm kërkimi i tyre përmes kërkuesit të internetit. Prandaj është e mundur që disa nga dokumentet e kërkuara në të vërtetë ndodhen në faqet e komunave, por pamundësia për tu gjetur dhe/ose mungesa e qasshmërisë edhe përmes kërkuesit i bënë ato të papërdorshëm për qytetarët dhe qytetarët të cilët kanë shumë më pak kohë ose dije që të merren me këtë formë të kërkimit. Shpesh ishte e nevojshme hapja e një sërë faqesh ose nënkategorish në faqe për të gjetur dokumentin e caktuar. Në thelb, qëllimi duhet të jetë azhurniteti, tërësia dhe saktësia së bashku me qasshmërinë e shpejtë dhe të lehtë për të gjithë subjektet e interesuara.

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I TRANSPARENCËS SË KOMUNAVE NË MAL TË ZI

E marrë në përgjithësi, komunat malazeze duhet të punojnë shumë më tepër për përmirësimin e hapjes dhe transparencës. Madje edhe komunat me vlerësimet më të larta për vitin 2019 – Podgorica dhe Bijello Pole – pak e tejkalojnë gjysmën e numrit të përgjithshëm të pikëve, gjegjësisht kanë nga 58 pikë.



Grafiku 1: Vlerësimi i përgjithshëm i të gjitha Komunave


Mirëpo, edhe situata e tillë është një hap përpara tek një pjesë e komunave në krahasim me hulumtimet e mëparshme të transparencës së komunave të cilat i realizoi QAQ-ja, edhe pse ato nuk ishin të hollësishme dhe sistematike siç është *Indeksi i Transparencës së Komunave Malazeze*. Po ashtu, faqet e internetit janë më interesante dhe më të qarta për nga ana vizuale se më herët, e që ia lehtëson përdoruesit kërkimin e informatave. Në shumicën e faqeve janë të vendosura disa pyetje me rëndësi për opinionin. Këto kategori në formën e banerave të veçantë gjenden në mes ose anash dhe përfshijnë buxhetin, prokurimet publike, dokumentet, qasjen e lirë të informatave, institucionet publike, etj.

Komuna më e re malazeze, ajo e Tuzit, po ashtu, ka faqen e internetit me koncept të qartë dhe të lehtë për kërkim, që vlerësohet si pozitive. Mirëpo, në pjesën përmbajtjesore ka nevojë për përmirësime serioze që pasqyrohet nga numri i përgjithshëm i pikëve të cilat kjo komunë i morri me kontrollin e të gjithë indikatorëve.

| Renditja | Emri i Komunës | Numri i pikëve |
|----------|---------------------------|----------------|
| 1. | Bijello Pole Podgoricë | 58 |
| 2. | Tivat | 56 |
| 3. | Nikshiq | 54 |
| 4. | Kotorr | 53 |
| 5. | Pluzhinë | 52 |
| 6. | Budvë | 49 |
| 7. | Herceg Novi | 47 |
| 8. | Mojkovac | 45.5 |
| 9. | Kollashin | 45 |
| 10. | Zhabjak Plevlë | 43 |
| 11. | Andrijevicë | 41 |
| 12. | Beranë Cetinë | 40 |
| 13. | Tuz | 38 |
| 14. | Ulqin | 37 |
| 15. | Danillovgrad | 35 |
| 16. | Petnicë | 33 |
| 17. | Tivar | 31 |
| 18. | Shavnik Plavë | 30 |
| 19. | Rozhajë | 25 |
| 20. | Gollubovci | 22 |
| 21. | Guci | 19 |


Tabela 1: Renditja e Komunave

Kur e vështrime këte renditje përmes fushave të veçanta sipas të cilave u vlerësua transparenca, vërehet se ka komuna të cilat veçohen në secilën prej tyre. Për shembull, kur bëhet fjalë për qasjen e informatave për punën e Kuvendit të Komunës veçohen Bijello Pole, Budva dhe Plevla, ndërsa në këtë kategori vlerësimin më të dobët e kanë Gollubovci dhe Gucia.




Grafiku 2: Vlerësimi i Komunave në kategorinë Kuvendi i Komunës

Për nga qasshmëria e të dhënave për buxhetin prijnë Podgorica, Zhabjaku dhe Bijello Pole, ndërsa në fund janë Rozhaja dhe Budva.




Grafiku 3: Vlerësimi i Komunave në kategorinë Buxheti

Në pjesën e luftës kundër korrupsionit më së shumti informata/dokumente të kërkuara kishin komnat e Kollashinit dhe Kotorrit, ndërsa vlerësimet më të dobëta i morën Tuzi, Tivari, Shavniku dhe Komuna Urbane e Gollubovcit.




Grafiku 4: Vlerësimi i Komunave në kategorinë Lufta kundër korrupsionit

Sa i përket qasshmërisë së informatave të përgjithshme renditjen e prijnë komunitet e Bijello Poles, Podgoricës dhe Tivatit, ndërsa Gollubovci, Guçia, Plava dhe Shavniku kishin vlerësimet më të dobëta.




Grafiku 5: Vlerësimi i Komunave në kategorinë Qasje e informatave

Kur është fjala për prokurimet publike, gjatë vitit 2019, më transparentja për nga indikatorët e vendosura, ishte Komuna e Tuzit (11 pikë), e njëkohësisht kjo është e vetmja fushë në të cilën një komunë fitoi numrin maksimal të pikëve. Në skajin tjetër është Komuna e Guçisë me një pikë në këtë fushë.



Grafiku 6: Vlerësimi i Komunave në kategorinë Prokurimet publike

Informatat për shqyrtimet publike dhe konkurset publike janë një nga fushat më të kritikuara të punës së vetëqeverisjes vendore. Mirëpo, ka komuna të cilat kanë një numër solid pikësh, e këtu prijnë komunat e Tivatit, Podgoricës, Plluzhinës, Nikshiqit, Budvës dhe Bijello Poles, gjersa në polin e kundërt janë shtatë komuna – Gucia, Rozhaja, Shavniku, Ulqini, Tuzi, Zhabjaku dhe Komuna Urbane e Gollubovcit.




Grafiku 7: Vlerësimi i Komunave në kategorinë Shqyrtimet publike dhe konkurset publike

Në fushën e luftës kundër korrupsionit në nivel vendor, e cila mbikëqyret nga QAQ-ja për vite të tëra, brengos fakti që as komunat malazeze nuk kanë qasje të njësuar, prandaj vazhdojmë të mos i kemi të gjithë planet e integritetit në faqet e internetit të komunave. Më saktësisht 10 komuna e kanë publikuar (Bijello Pole, Komuna Urbane e Gollubovcit, Gucia, Kollashini, Kotorri, Mojkovaci, Nikshiqi, Plava, Ulqini dhe Zhabjaku) ndërsa 14 nuk e kanë publikuar në faqen e vet planin e integritetit. Ka shembuj kur plani i integritetit është publikuar, mirëpo nga përmbajtja e dokumentit nuk është qartë periudha të cilën e mbulon. Asnjë komunë nuk e ka raportin e publikuar për realizimin e planit të integritetit.

Siç duket, planet lokale të veprimit e kanë humbur rëndësinë e vet, edhe pse, sipas aktiviteteve të disa komunave të cilët mund të vërehen në faqet e tyre, përdoren për fushat specifike (komunat e Beranës, Nikshiqit dhe kryeqyteti Podgoricë).

Komunat vazhdojnë të mos i japin rëndësi respektimit të nenit 22 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata, e i cili parasheh edhe publikimin dhe përditësimin vjetor të Manualit për Qasje të Lirë në Informata. Manualët e përditësuar për Qasje të Lirë në Informata për vitin 2019 u publikuan në faqet e internetit të këtyre komunave: Bijello Pole, Danillovgrad, Kollashin, Plevlë, Plluzhinë, Rozhajë, Tivat, Tuz, Ulqin dhe Zhabjak. Në faqet e komunave tjera gjenden manualët e caktuar, por nuk është gjithmonë e qartë se cilën periudhë ato mbulojnë. Në disa komuna u miratuan në fund të dhjetorit të vitit 2018, prandaj skuadra hulumtuese e vlerësoi se vlejné për vitin 2019, dhe në këto raste por edhe kur u publikuan si dokumente të paplota u vlerësuan me gjysmë pike.

SA TRANSPARENTE JANË KOMUNAT MALAZEZE?




ANDRIJEVIÇË

<http://opstinaandrijevisa.me>

Komuna e Andrijeviçës është një nga komunat me vlerësimet më të mira me 41 pikë nga 100 maksimale.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si vijon: Kuvendi i Komunës – 5; Buxheti – 10; Lufta kundër korrupsionit – 5; Qasja e informative – 8; Prokurimet publike – 9; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 4.



Grafiku 8: Vlerësimi sipas fushave në Komunën e Andrijeviçës

Fakti që shumë e pikëve është nën gjysmën e maksimumit tregon nevojë e punës së mëtejme për zhvillimin e transparencës së kësaj komune dhe proaktivitetit të saj sa i përket publikimit të informatave me rëndësi publike.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga dhjetë dokumente që u kërkuan në faqen e internetit të Komunës së Andrijeviçës, u gjetën vetëm katër – vendime të plota të cilat në vitin 2019 i miratoi Kuvendi i Komunës së Andrijeviçës (2 pikë) dhe lista e këshilltarëve (2 pikë), gjersa të pjeshme ishin rezultatet e votimeve nga mbledhjet (0.5 pikë) dhe procesverbalet nga mbledhjet, meqë ekzistojnë vetëm për pesë muaj gjatë vitit 2019 (0.5 pikë).

Në faqen e Komunës së Andrijeviçës nuk ka informata se si votuan këshilltarët krye për

emër në vitin 2019, mbi amandamentet e dorëzuara për aktet e shqyrtuara, arsyetimet e amendamenteve të dorëzuara, për rendin e ditës të mbledhjes së ardhshme të Kuvendit të Komunës, kontaktet e këshilltarëve, si dhe a transmetohen drejtpërdrejtë seancat përmes ndonjërit nga mediat lokale.

• BUXHETI

Kur flasim për buxhetin e Komunës së Andrijevicës për vitin 2019, nga gjithsej 10 dokumente të kërkuara në faqen e internetit të kësaj komune janë të publikuar gjashtë. Këtu përfshihet Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), Raporti për realizimin e Buxhetit (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë), Informata për mbajtjen e shqyrtimit publik për Buxhetin (2 pikë), si dhe Buxheti për vitin 2020 (1 pikë).

Hulumtuesit nuk arritën të gjejnë arsyetimin e Buxhetit për vitin 2019 në faqen e internetit, e as Buxhetin në formatin e lexueshëm për nga ana mekanike (.xls ose .xlsx) por vetëm në formatin PDF. Po ashtu, nuk ekziston as manuali për qytetarët dhe qytetaret ose informata se a është shqyrtuar Llogaria Përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019 të Komunës së Andrijevicës.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Kur bëhet fjalë për luftën kundër korrupsionit, nga 13 informata/dokumente të kërkuara të qasshme janë vetëm tre sosh – Kodeksi etik për të punësuarit (2 pikë), Plani lokal antikorrupтив (1 pikë) dhe raporti për pronën e kryetarit të komunës për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekzistojnë informatat rreth mekanizmave që mund të përdoren për denoncimin e korrupsionit, e as opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë në punën e shërbimeve të Komunës, gjegjësisht shkeljet e ligjit, duke e treguar identitetin e plotë ose në mënyrë anonime. Përveç kësaj, nuk ekziston as raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të proceduara për vitin 2019, e as a u miratua Plani i Integritetit për periudhën 2018 – 2020 me raportin për realizimin e tij. Po ashtu, nuk u publikuan as informatat për rrogat e funksionarëve dhe zyrtarëve dhe as personi i kontaktit i cili caktua për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve.

• QASJE E INFORMATAVE

Nga gjithsej 15 informata/dokumente të kërkuara, ekzistojnë të dhënat për kryetarët e bashkësive lokale (2 pikë), kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë), Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës (1 pikë), Plani strategjik i zhvillimit të komunës (2 pikë) dhe të dhënat për numrin e të punësuarve në këtë komunë (1 pikë).

Nuk janë të qasshme të dhënat për orarin e punës të vetëqeverisjes vendore, e as regjistrat koherent të inspektorateve të Komunës, as të dhënat për veprimet sipas ankesave dhe vërejtjeve. Po ashtu, në faqe nuk është theksuar dhe as përcaktuar periudha për pranimin e qytetarëve tek kryetari i Komunës, nuk ka Plan vjetor të punës së Komunës, Raportin

e punës për vitin 2019, të dhënat për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike, Manualit për qasjen e informatave për vitin 2019 dhe as pasqyrimin e informatave të aprovuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata ose të personit të kontaktit për vendosjen sipas kërkesave për qasjen e lirë në informata.

• PROKURIMET PUBLIKE

Në faqen e internetit të Komunës së Andrijevicës ekziston seksioni i paraparë për prokurimet publike (1 pikë) me të dhënat për konkurset e publikuara për prokurimet publike (2 pikë) dhe të dhënat për ofertuesin e përzgjedhur, si dhe për prokurimet publike të realizuara gjatë vitit 2019. Në faqe u publikua edhe Plani i prokurimeve publike për vitin 2019 (2 pikë), por nuk ka raport për realizimin e Planit të prokurimeve publike për vitin 2019.

• SHQYRTIMET DHE KONKURSET PUBLIKE

Ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike të organizuara gjatë vitit 2019 (2 pikë), u publikuan konkurset (1 pikë) dhe rezultatet e konkursit për ndarjen e mjeteve për OJQ-të (1 pikë). Nga ana tjetër, pjesë e raporteve nga shqyrtimet publike nuk janë të dhënat me të cilët pasqyrohen propozimet e subjekteve të interesuara, e as të dhënat për arsyet e pranimit ose refuzimit të propozimit. Nuk u publikuan konkurset për media dhe as rezultatet e konkurseve të tilla për vitin 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Andrijevicës


41
pikë

TIVAR

www.bar.me

Komuna e Tivarit, sipas indikatorëve të këtij hulumtimi, fitoi 31 pikë, që e vendos në fundin e komunave malazeze për nga transparenca.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si vijon: Kuvendi i Komunës – 6; Buxheti – 6; Lufta kundër korrupsionit – 2; Qasja e informative – 8; Prokurimet publike – 5; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 4.



Grafiku 9: Vlerësimi sipas fushave në Komunën e Tivarit

Komuna e Tivarit ka, nga ana vizuale, faqe të kënaqshme dhe të qartë, por mangësitë identifikohen në pjesën e përmbajtjes, gjegjësisht të dhënave që parashihen me ligj, si dhe të atyre që janë të nevojshme për qytetarët dhe qytetaret.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 dokumenteve të kërkuara, u gjetën vetëm tre – vendime të cilat gjatë vitit 2019 i miratoi Kuvendi i Komunës së Tivarit (2 pikë), rendi i ditës i mbledhjes së ardhshme (2 pikë) dhe regjistri i këshilltarëve (2 pikë).

Nuk u gjetën këto dokumente: rezultatet e votimit nga seancat e Kuvendit të Komunës në vitin 2019, të dhënat si votuan këshilltarët krye për emër në vitin 2019, amendamentet e dorëzuara në aktet e propozuara që u shqyrtuan, e as arsyetimet e amendamenteve të dorëzuara në vitin 2019. Po ashtu, nuk u publikuan kontaktet e

këshilltarëve, procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, e as të dhënat a transmetuan seancat gjatë vitit 2019 (ekziston vetëm informata për realizimin e Kontratës për ofrimin e shërbimeve publike në mes të Komunës së Tivarit dhe Radios së Tivarit për vitin 2018, ndërsa u shqyrtua në dhjetor të vitit 2019⁷).

• BUXHETI

Sa i përket buxhetit, në faqe janë të publikuara katër informata/dokumente. Këtu bëjnë pjesë Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë), Informata për shqyrtimin e mbajtur publik për Buxhetin e vitit 2019 (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekziston arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, Buxheti për vitin 2019 në formatin e lexueshëm nga ana mekanike, Raporti për realizimin e Buxhetit për vitin 2019, manuali për qytetarët dhe qytetaret, Raportet për mbajtjen e shqyrtimit publik për Buxhetin, si dhe Llogaritë përfundimtare për Buxhetin e vitit 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në aspektin e luftës kundër korrupsionit, nga 13 informata/dokumente të kërkuara për nevojat e këtij hulumtimi në faqen e internetit të Komunës së Tivarit nuk ishte asnjë. E vetmja informatë e qasshme nga ky korpus i pyetjeve, e cila gjendet në faqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ka të bëjë me raportin për pronën e kryetarit të Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekzistojnë informatat rreth mekanizmave që mund të përdoren për denoncimin e korrupsionit, e si rrjedhojë as opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë ose shkeljen e ligjeve. Në faqe nuk ekzistojnë as raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të proceduara për vitin 2019, Kodeksi etik për të punësuarit, Plani i Integritetit dhe Plani Vendor Antikorrupsion dhe as raporti për realizimin e këtyre planeve. Po ashtu, nuk u publikuan as informatat për rrogat e funksionarëve dhe zyrtarëve dhe as kontaktit i personit i cili emërua për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Në pjesën e qasshmërisë së informatave nga gjithsej 15 informata/dokumente të kërkuara, në faqen e internetit të Komunës së Tivarit gjenden pesë – orari i punës së Komunës së Tivarit (2 pikë), lista e inspektorateve të Komunës (1 pikë), të dhënat e kontaktit të Kryetarit të Komunës (2 pikë), Manuali për Qasjen e Lirë në Informata (1 pikë) dhe kontakti i personit për marrjen e vendimeve sipas kërkesave për qasje të lirë në informata (2 pikë).

Nuk ekzistojnë informatat që kanë të bëjnë me regjistrin e inspektorateve të Komunës, të vepruarit në bazë të ankesave dhe vërejtjeve, kontaktet e kryetarëve të bashkësive

⁷ <http://bar.me/saziv-xviii-sjednice/>

lokale, orari i pranimit të qytetarëve dhe qytetareve tek kryetari, Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës ose Plani Vjetor i Komunës dhe as Raporti për Punën e Komunës për vitin 2019. Në faqe nuk janë publikuar as të dhënat për të punësuarit në Komunë ose për të punësuarit në institucionet dhe ndërmarrjet publike, por as qasja e informatave të aprovuara në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata.

• PROKURIMET PUBLIKE

Komuna e Tivarit nga gjashtë informatat/dokumentet e kërkuara, i bëri publike prokurimet publike në pjesën e veçantë në faqen e internetit (1 pikë), të dhënat për ofertuesit e zgjedhur (2 pikë) dhe për prokurimet publike të realizuara në vitin 2019 (2 pikë). Mirëpo, në faqen e internetit nuk ekzistojnë të dhënat mbi konkurset për prokurimet publike, Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019, por as Raporti për realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

• SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE

Nga shtatë informata/dokumente të kërkuara në pjesën e shqyrtimeve publike dhe konkurseve publike, të publikuara janë informatat për shqyrtimet e mbajtura publike gjatë vitit 2019 (2 pikë), si dhe konkurset dhe rezultatet e konkurseve për ndarjen e mjeteve për OJQ-të (1+1 pikë).

Skuadra hulumtuese nuk arriti të gjejë raportet nga shqyrtimet publike të cilët përbëjnë propozimet e palëve të interesuara ose arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre. Po ashtu, në faqen e internetit nuk ekzistojnë informatat për konkurset e publikuara për ndarjen e mjeteve për media dhe rezultatet e këtij konkursi.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Tivarit


31
pikë

BERANË

www.berane.me

Komuna e Beranës në këtë hulumtim fitoi 40 pikë, rezultat i cili e radhit në kategorinë e komunave me transparencë të mesme.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 8; Buxheti – 7; Lufta kundër korrupsionit – 9; Qasja e informative – 9; Prokurimet publike – 3; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 4.



Grafiku 10: Vlerësimi sipas fushave në Komunën e Beranës

Faqja e internetit e Komunës së Beranës është e ndarë sipas fushave të cilat janë të nevojshme për mbikëqyrjen e politikave publike. Mirëpo, mungojnë disa të dhëna kyçe që janë të rëndësishme për qytetarët dhe qytetaret.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 informata/dokumente të kërkuara në faqen e internetit të Komunës së Beranës, skuadra hulumtuese gjeti pesë – vendime të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Beranës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rezultatet e votimit në seancat plenare (1 pikë), rendi i ditës në seancën e radhës (2 pikë), lista e këshilltarëve (2 pikë) dhe informatat për transmetimet e drejtpërdrejta në media të seancave plenare të Kuvendit të Komunës (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk ka të dhëna rreth votimit të këshilltarëve në seancat plenare gjatë vitit 2019, as për amendamentet në propozim vendimet e shqyrtuara dhe

arsyetimet përcjellëse të këtyre amendamenteve. Po ashtu, mungojnë të dhënat për kontaktet e secilit këshilltar dhe procesverbalet nga seancat.

• BUXHETI

Pjesa e faqes së internetit e cila ka të bëjë me buxhetin përmban Buxhetin e Komunës së Beranës për vitin 2019 (2 pikë), Raportin për realizimin e Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë), Thirrjen publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë), Informatën se u mbajt shqyrtimi publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë) dhe Buxhetin për vitin 2020 (1 pikë).

Mungojnë arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, Udhëzuesi për qytetarë i buxhetit dhe vet Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik. Po ashtu, në faqen e internetit nuk u publikuan Raporti i shqyrtimit publik për Buxhetin dhe Llogaria përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në pjesën e cila ka të bëjë me informatat mbi luftën kundër korrupsionit, në faqen e internetit të Komunës së Beranës, qytetarët dhe qytetaret kanë qasje në sistemin për denoncimin e parregullsive, gjegjësisht të shkeljeve të ligjit (2 pikë), Kodeksi etik për të punësuarit (2 pikë), Plani Lokal i Antikorrupsionit për periudhën 2018 – 2020 (2 pikë), si dhe informatat për pagat e funksionarëve (1 pikë). Po ashtu, i publikuar është edhe raporti për pronën e kryetarit të Komunës për vitin 2019 (2 pikë).

Mirëpo, nuk ekzistojnë të dhënat mbi mekanizmat për denoncimin e korrupsionit në Komunën e Beranës, as anonimiteti i denoncimeve, por as raporti ose informata mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të proceduara gjatë për vitin 2019. Përveç këtyre, nuk janë të publikuara as Plani i Integritetit dhe Raporti për realizimin e tij, Raporti për realizimin e Planit Lokal të Antikorrupsionit, informatat për pagat e zyrtarëve, e as kontakti i personit përgjegjës për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Informatat e përgjithshme, sipas indikatorëve të përcaktuara në hulumtim, të cilat ekzistojnë në faqen e internetit të Komunës së Beranës janë të kufizuara. Nga 15 informatat/dokumentet e kërkuara ekzistojnë pesë. Ato përfshijnë listën e inspektorateve të Komunës, gjegjësisht vetëm të Inspektoratit të Komunës (1 pikë), kontaktin e kryetarit të Komunës (2 pikë), numrin e të punësuarve në Komunë (1 pikë), pasqyrimin e informatave të lejuara, në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë), Udhëzuesin për Qasjen e Lirë në Informata (1 pikë), dhe kontaktin e personit i cili merr vendimet sipas kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Nuk ekzistojnë të dhënat për orarin e punës të Komunës, të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve, e nuk ekzistojnë as të dhënat kontaktuese të kryetarëve të bashkësive lokale. Po ashtu, nuk është i afishuar orari i pranimit të qytetarëve dhe qytetareve tek

kryetari i Komunës, as Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës. Mungojnë edhe Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës, Plani Vjetor i Punës së Komunës, Raporti i punës për vitin 2019, por edhe numri i të punësuarve në institucionet publike.

• PROKURIMET PUBLIKE

Kjo është një nga fushat e vlerësuara më dobët në analizën e Komunës së Beranës, kur bëhet fjalë për ekzistencën e informatave në faqen e internetit, me vetëm tre pikë. Në faqen e internetit ekziston seksioni i përcaktuar për prokurimet publike (1 pikë) dhe të dhënat mbi konkurset për prokurimet publike (2 pikë). Mirëpo, nuk ka të dhëna për ofertuesit e përzgjedhur, prokurimet publike të realizuara në vitin 2019, Planin e prokurimeve publike për vitin 2019, as raportin për realizimin e tij.

• SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE

Nga shtatë informatat/dokumentet e kërkuara, në faqen e internetit të Komunës së Beranës u publikuan vetëm tre – të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara (2 pikë), konkurset për ndarjen e mjeteve për OJQ-të në vitin 2019 (1 pikë) dhe rezultatet e konkursit për ndarjen e këtyre mjeteve (1 pikë). Të dhënat për propozimet e subjekteve të interesuara, arsyetimet për pranimin ose refuzimin e tyre, konkurset për ndarjen e mjeteve mediave dhe rezultatet e këtyre konkurseve për vitin 2019, nuk u identifikuan në faqen e internetit të Komunës.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Beranës


40
pikë

BIJELLO POLE

www.bijelopolje.co.me

Komuna e Bijello Poles, sipas indikatorëve të këtij hulumtim, korri 58 pikë që e bënë një të njëjtën nga dy komunat më transparente në Mal të Zi për vitin 2019.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 11; Buxheti – 11; Lufta kundër korrupsionit – 9; Qasja e informative – 17; Prokurimet publike – 2; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 8.



Grafiku 11: Vlerësimi sipas fushave në Komunën e Bijello Poles

Faqja e internetit e Komunës së Bijello Poles është një nga dy faqet të cilat, në krahasim me komunat tjera malazeze, përmban sasinë më të madhe të informatave të kërkuara përmes këtij hulumtimi, por edhe të atyre që janë të obligueshme me kornizën ligjore. Bëhet fjalë për informatat me rëndësi publike, e të cilat janë të nevojshme për mbikëqyrjen e drejtë të politikave publike, si dhe informimin e qytetarëve dhe qytetarëve për punët e Komunës.

• KUVENDI I KOMUNËS

Komuna e Bijello Poles siguroi shtatë nga dhjetë informatat e kërkuara në këtë kategori – vendimet e miratuara të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), duke përfshirë edhe rezultatet e votimit nga seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019 (1 pikë), rendin e ditës për seancën e ardhshme (2 pikë), si dhe

regjistrin e këshilltarëve (2 pikë) me kontaktet (2 pikë). Në faqen e Komunës së Bijello Poles ekzistojnë procesverbalet nga seancat plenare (1 pikë), ndërsa seancat transmetohen përmes radio stacionit lokal (1 pikë), për çka ekziston informata.

Në faqen e internetit nuk ka të dhëna rreth votimit të këshilltarëve në seancat plenare gjatë vitit 2019, as për amendamentet në propozim vendimet e shqyrtuara dhe arsyetimet përcjellëse të këtyre amendamenteve.

• BUXHETI

Sa i përket publikimit të informatave që kanë të bëjnë me buxhet, në faqen e internetit janë Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), Raporti për realizimin e Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë), Udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret (1 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin për vitin 2019 (1 pikë), Informata se u mbajt shqyrtimi publik (2 pikë), si dhe Raporti i shqyrtimit publik (2 pikë) dhe Buxheti për vitin 2020 (1 pikë).

Mungojnë arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, Buxheti i vitit 2019 në formatin e lexueshëm mekanik dhe Llogaria përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në faqen e Komunës së Bijello Poles ekzistojnë të dhënat mbi mekanizmat për denoncimin e korrupsionit në Komunë (2 pikë), si dhe mundësia që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljet e ligjit nga ana e shërbimeve vendore. Po ashtu, ekziston informata për denoncimet dhe përgjigjet e dhëna Komuna, si dhe statusi i denoncimeve, së bashku me aplikacionin android si shtojcë (2 pikë). Ekziston Kodeksi Etik për të punësuarit (2 pikë) dhe Plani i Integritetit (2 pikë), ndërsa u publikuan edhe pagat e funksionarëve (1 pikë).

Nga ana tjetër, nuk ekziston mundësia që, në mënyrë anonime, të denoncohet korrupsioni ose parregullsitë në punë, ndërsa mungojnë edhe informatat mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të proceduara gjatë vitit 2019. Po ashtu, nuk u publikuan Raporti për realizimin e Planit të Integritetit, Plani Lokal i Antikorrupsionit dhe as Raporti për realizimin e tij. Përveç këtyre, mungonte kontakti i personit përgjegjës për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve, ndërsa kryetari deri në mbylljen e këtij hulumtimi nuk ka dorëzuar raportin për pronën për vitin 2019.

• QASJA E INFORMATAVE

Në këtë pjesë të hulumtimit, Komuna e Bijello Poles i publikoi të dhënat për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve në sistemin 48h (2 pikë), listën e inspektorateve të Komunës përveç Policisë Komunale (1 pikë), të dhënat kontaktuese të kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë), kontaktin e kryetarit të Komunës (2 pikë), Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës (1 pikë), Planin Strategjik të Zhvillimit të Komunës (2 pikë), të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë (1 pikë). Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë), pasqyrimin e informatave të lejuara, në bazë

të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë), si dhe kontaktin e personit i cili merr vendimet sipas kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Nuk u publikuan të dhënat për orarin e punës të vetëqeverisjes vendore dhe as nuk u afishua orari i pranimit të qytetarëve dhe qytetareve tek kryetari i Komunës. Nuk ekziston Plani Vjetor i Punës dhe Raporti i Punës, por as numri i të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit ekziston seksioni i përcaktuar për prokurimet publike (1 pikë) dhe të dhënat mbi konkurset për prokurimet publike, por vetëm pjesërisht, pra vetëm për prokurimet me vlerë të vogël (1 pikë). Mirëpo, nuk ka të dhëna për ofertuesit e përzgjedhur, prokurimet publike të realizuara në vitin 2019, Planin e prokurimeve publike për vitin 2019, as raportin për realizimin e tij.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara (2 pikë), me propozimet subjekteve të interesuara (2 pikë), me arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre (2 pikë), si dhe konkurset për ndarjen e mjeteve për organizatat e shoqërisë civile dhe rezultatet e konkursit në vitin 2019 (1 + 1 pikë) ekzistojnë në faqen e internetit të Komunës së Bijello Poles. Mungojnë të dhënat për konkurset dhe ndarjen e mjeteve për media.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Bijello Poles


58
pikë

BUDVË

www.budva.me

Komuna e Budvës, sipas indikatorëve të këtij hulumtimi, ka 49 pikë, që e radhitë ndër komunat më transparente në Mal të Zi.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 11; Buxheti – 4; Lufta kundër korrupsionit – 8; Qasje e informative – 9; Prokurimet publike – 9; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 8.



Grafiku 12: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Budvës

Faqja e internetit e Komunës së Budvës ka një numër të konsiderueshëm të informatave, por dhe mangësi në pjesën përmbajtjesore. Kjo pasqyrohet nga fakti se përkundër rezultatit të mirë, shumica e përgjithshme e pikëve të Komunës së Budvës nuk e kalon gjysmën e numrit të mundshëm të pikëve.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga të dhënat e parapara për këtë fushë, të publikuara ishin vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Budvës gjatë vitit 2019 (2 pikë) me rezultatet e votimit në seancat plenare (1 pikë). Po ashtu, në faqe janë amendamentet në propozim vendimet e shqyrtuara (2 pikë), me arsyetimet përcjellëse (1 pikë), pastaj rendin e ditës nga seancat plenare (2 pikë), regjistri i këshilltarëve (2 pikë), si dhe informata se seancat plenare transmetohen në Radio Budva (1 pikë).

Nuk ekzistojnë të dhënat rreth votimit të këshilltarëve në seancat plenare, kontaktet e këshilltarëve dhe procesverbalet e hollësishme nga seancat plenare të Kuvendit të Komunës së Budvës.

• BUXHETI

Në faqe ishte i publikuar Buxheti i Komunës së Budvës për vitin 2019 (2 pikë), me Udhëzuesin e buxhetit për qytetarët (1 pikë), si dhe Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë).

Nga ana tjetër, mungojnë arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, raporti për realizimin e Buxhetit, Informata se a është realizuar shqyrtimi publik, as Raporti për shqyrtimet publike. Po ashtu, në faqe nuk është publikuar as Buxheti i Komunës së Budvës për vitin 2020.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në pjesën e cila ka të bëjë me mekanizmat antikorrptiv, nga 13 informata të kërkuara dhe të parapara me hulumtim, në faqen e Komunës së Budvës janë vetëm tre – informata për mekanizmat për denoncimin e korrupsionit (2 pikë), opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë në punën e shërbimeve lokale, gjegjësisht shkeljen e ligjit (2 pikë) dhe Kodeksin Etik për të punësuarit (2 pikë). Ekziston edhe Raporti për pronën e kryetarit të Komunës për vitin 2019 në faqen e internetit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsioni (2 pikë).

Në faqen e internetit të Komunës së Budvës nuk ekziston mënyra për denoncimin anonim të korrupsionit dhe të parregullsive në punën e organeve vendore, nuk është i publikuar raporti ose informata mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të procedura gjatë vitit 2019, as Plani i Integritetit me raportin për realizimin e tij, ndërsa e njëjta gjë vlen edhe për Planin Lokal të Antikorrupsionit me raportin përcjellës për realizimin e tij. Nuk ka informata për pagat e funksionarëve dhe zyrtarëve, ndërsa mungon edhe kontakti i personit përgjegjës për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Kur flasim për qasshmërinë e informatave të përgjithshme, Komuna e Budvës ia bëri të qasshme opinionit informatat/dokumentet që kanë të bëjnë me kontaktet e kryetarit të Komunës (2 pikë), kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë), regjistrin e inspektorateve të Komunës përveç Policisë Komunale dhe Inspektoratit Komunal (1 pikë), Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës (1 pikë), të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë (1 pikë), si dhe pasqyrimin e informatave të lejuara, në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë).

Mirëpo, nuk u publikuan informatat për orarin e punës së vetëqeverisjes vendore, informata mbi të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve të qytetarëve dhe qytetareve, dhe as nuk është publike informata për orarin e pranimit të qytetarëve dhe qytetareve

tek kryetari i Komunës. Po ashtu, nuk ekzistojnë Plani Strategjik i Komunës dhe Plani Vjetor i Punës së Komunës. Nuk ka të dhëna as për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike, nuk është i përditësuar Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata dhe as kontakti i personit për zgjidhjen e kërkesave për qasjen e lirë në informata.

• PROKURIMET PUBLIKE

Në faqen e internetit të Komunës së Budvës ekziston seksioni i veçantë për prokurimet publike (1 pikë), si dhe të dhënat mbi konkurset për prokurimet publike (2 pikë) dhe ofertuesit e përzgjedhur (2 pikë). Përveç kësaj, ekzistojnë të dhënat për prokurimet publike të realizuara për vitin 2019 (2 pikë) dhe Planin e prokurimeve publike për vitin 2019 (2 pikë). I vetmi dokument që mungon është Raporti për realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

• SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE

Në këtë pjesë, ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara gjatë vitit 2019, përveç Buxhetit (2 pikë), Raportet për shqyrtimet publike të realizuara me të dhënat për propozimet e subjekteve të interesuara (2 pikë) dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve (2 pikë), konkursi dhe vendimi për ndarjen e mjeteve për organizata e shoqërisë civile në vitin 2019 (1+1 pikë). Në faqe nuk ka të dhënat për konkurset apo ndarjen e mjeteve për mediat gjatë vitit 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Budvës

49
pikë

CETINË

www.cetinje.me

Komuna e Fronit Cetina, me 40 nga gjithsej 100 pikë, gjendet në kategorinë e komunave me transparencë të mesme.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 4; Buxheti - 8; Lufta kundër korrupsionit - 6; Qasja e informative - 7; Prokurimet publike - 9; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 6.



Grafiku 13: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Fronit Cetinës

Faqja e internetit e Komunës së Fronit Cetinës është e kategorizuar sipas fushave të cilat përmbajnë dokumentacionin dhe informata nga fusha e politikave publike dhe shërbimeve ndaj publikut. Por, kjo faqe, në disa pjesë, nuk është e përditësuar nga ana përmbajtjesore dhe mungojnë të dhënat e rëndësishme.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 informata/dokumente të kërkuara përmes indikatorëve të këtij hulumtimi, në faqen e Komunës së Fronit Cetinës janë të publikuar vetëm dy – rendi i ditës i seancës së ardhshme plenare të Kuvendit të Komunës së Fronit (2 pikë) dhe lista e këshilltarëve (2 pikë).

Në faqen e vetëqeverisjes vendore në Cetinë nuk ka rezultate të votimit në seancat plenare, as të dhëna rreth votimit të këshilltarëve në vitin 2019. Po ashtu, nuk ekzistojnë

kontaktet e këshilltarëve, as vendimet që u miratuan gjatë vitit 2019, amendamentet në propozim vendimet e shqyrtuara dhe arsyetimet përcjellëse të tyre. Nuk janë të publikuara informatat për transmetimin e seancave plenare përmes mediave lokale, as procesverbalet nga seancat plenare të Kuvendit të Komunës së Fronit.

• BUXHETI

Nga 10 dokumente të kërkuara në fushën e buxhetit, në faqen e internetit të kësaj Komune janë të publikuara pesë – Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik të Buxhetit për vitin 2019 (1 pikë), Informatën se u mbajt shqyrtimi publik i Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë), Raporti i shqyrtimit publik (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë).

Në faqe nuk arritëm të gjejmë arsyetimin e Buxhetit për vitin 2019, Buxhetin për vitin 2019 në formatin e lexueshëm mekanik, Raportin për realizimin e Buxhetit për vitin 2019, Udhëzuesin e buxhetit për qytetarë dhe qytetare, e as Informatën se a u shqyrtua Llogaria Përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Nga 14 informata/dokumente të kërkuara në këtë pjesë janë të publikuara vetëm tre – opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljen e ligjit përmes sistemit 48h (2 pikë), Kodeksi Etik për të punësuarit (2 pikë) dhe raporti për pronën e kryetarit të Komunës (2 pikë).

Në faqe nuk ekzistojnë informatat mbi mekanizmat për denoncimin e korrupsionit, që do të thotë se nuk ekziston as mundësia e denoncimit anonim të këtyre rasteve. Po ashtu, nuk ekziston as raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të proceduara gjatë vitit 2019, as informata për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2018 – 2020. Nuk u publikuan Planin Lokal i Antikorrupsionit, Plani i Integritetit dhe as raporti për realizimin e këtyre Planeve. Përveç këtyre, nuk janë publikuar as informatat mbi pagat e zyrtarëve dhe funksionarëve, e as kontakti i personit përgjegjës për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Nga 15 informata/dokumente të kërkuara, në faqen e Komunës së Fronit Cetinës u identifikua lista e inspektorateve të Komunës (1 pikë), kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë) dhe kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë). Plani Vjetor i Punës (1 pikë) dhe pasqyrimi i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata (1 pikë).

Nuk ekzistojnë të dhënat për orarin e punës të Komunës së Fronit, për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve. Në faqe, po ashtu, nuk u afishua orari i pranimit të qytetarëve dhe qytetareve tek kryetari i Komunës së Fronit, ndërsa nuk u publikuan Raporti i Punës i vetëqeverisjes vendore, Plani Strategjik i Zhvillimit dhe të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunën e Fronit. Gjithashtu, nuk ekzistojnë Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës, të dhënat

për numrin e të punësuarve në Komunën e Fronit, Udhëzuesi për Qasjen e Lirën në Informata dhe kontaktin e personit i cili merr vendimet sipas kërkesave për qasjen e lirë në informata.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e Komunës së Cetinës ekziston seksioni i përcaktuar për prokurimet publike (1 pikë) me të dhënat mbi konkurset për prokurimet publike (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë). Po ashtu, ekzistojnë të dhënat për prokurimet publike të realizuara në vitin 2019 (2 pikë) dhe Planin e prokurimeve publike për vitin 2019, gjersa nuk u publikua Raporti për realizimin e planit të Prokurimeve publike për vitin 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

U publikuan të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara (2 pikë), propozimet e subjekteve të interesuara në raportet për shqyrtimet publike dhe të dhënat për arsyet për pranimin apo refuzimin e këtyre propozimeve. Nuk ekzistojnë të dhënat për konkurset ose mjetet e ndara për media për vitin 2019, as informatat mbi konkurset për ndarjen e mjeteve organizatave të shoqërisë civile për vitin 2019 dhe mënyrën e ndarjes së tyre.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Fronit Cetinës


40
pikë

DANILLOVGRADI

www.danillovgrad.me

Komuna e Danillovgradit është një nga Komunitatet me vlerësime më të dobëta në hulumtimin e QAA-së nga viti 2018 për transparencën e vetëqeverisjeve vendore, ndërsa në këtë periudhë u përmirësua dhe tani ka 35 pikë.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 6; Buxheti – 6; Lufta kundër korrupsionit – 3; Qasja e informatave – 11; Prokurimet publike – 5; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 4.



Grafiku 14: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Danillovgradit

Komuna e Danillovgradit bëri një hap para sa i përket transparencës së vet dhe pamjes së vet faqes së internetit e cila tani është më e qartë për përdoruesit. Mirëpo, vazhdon mos publikimi i një numri të madh të informatave/dokumenteve, prandaj nevojiten përmirësime serioze.

• KUVENDI I KOMUNËS

Në faqen e internetit të Komunës së Danillovgradit ekzistojnë vendimet e Kuvendit të Komunës të cilët janë miratuar gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës i seancave plenare të Kuvendit të Komunës (2 pikë) dhe regjistri i këshilltarëve (2 pikë).

Mungojnë një sërë dokumentesh/informatash, siç janë: rezultatet e votimit të këshilltarëve në seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019, si votuan

këshilltarët krye për emër, amendamentet në propozim vendimet e shqyrtuara në seancat plenare të Kuvendit të Komunës në vitin 2019, arsyetimet përcjellëse të amendamentet, kontaktet e këshilltarëve, procesverbalet nga seancat plenare dhe informata për transmetimet e drejtpërdrejta në mediat lokale.

• BUXHETI

Të vetmet të dhëna që mund të gjenden në faqen e internetit të Komunës së Danillovgradit, në këtë lëmi, janë Thirrja Publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë), Informata se u mbajt shqyrtimi publik për Buxhetin e vitit 2019 (2 pikë), Raporti për shqyrtimin publik (2 pikë) dhe Buxheti për vitin 2020.

Në faqe nuk ekziston Buxheti për vitin 2019, i cili me gjasë është fshirë nga faqja e internetit, por as arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, si rrjedhojë nuk ekziston as Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik, as Raporti për realizimin e Buxhetit. Përveç këtyre, nuk ekziston as Udhëzuesi i buxhetit për qytetarët dhe qytetaret dhe as Llogaria përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në faqen e internetit të Komunës së Danillovgradit nuk ekziston informata mbi mekanizmat e denoncimit të korrupsionit, as mënyra në të cilët qytetarët dhe qytetaret e interesuar mund të denoncojnë parregullsitë dhe shkeljet e ligjit nga ana e shërbimeve lokale, e si rrjedhojë nuk ekziston as mundësia e denoncimeve anonime.

Në faqe nuk ekziston as raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të procedura në vitin 2019, por as Kodeksi etik për të punësuarit, Plani i Integritet, Plani Lokal i Antikorrupsionit, por as raporti për realizimin e këtyre planeve. Po ashtu, nuk ekzistojnë informatat për pagat e zyrtarëve dhe as s'u emërua personi përgjegjës për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve. Të vetmet dy informata që mund të qasen janë pagat e funksionarëve (1 pikë) dhe raporti për pronën e kryetares së Komunës.

• QASJA E INFORMATAVE

Në këtë pjesë në faqen e internetit të Komunës së Danillovgradit ekzistojnë të dhënat e kontaktit të kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë), kontakti i kryetares së Komunës (2 pikë), Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës (2 pikë), të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunën e Danillovgradit (1 pikë), Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë), pasqyrimi i informatave të lejuara, në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontakti i personit i cili merr vendimet sipas kërkesave për qasjen e lirë në informata.

Mirëpo, nuk ekzistojnë të dhënat për orarin e punës, regjistri i inspektorateve të Komunës, të dhënat e të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve, orari për pranimin

e qytetarëve dhe qytetareve tek kryetarja e Komunës së Danillovgradit, Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës, Plani vjetor i punës së Komunës, pastaj Raporti i Punës së Komunës, numri i të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike dhe kontakti i personit i cili merr vendimet sipas kërkesave për qasjen e lirë në informata.

• PROKURIMET PUBLIKE

Komuna e Danillovgradit në faqen e vet të internetit e ka seksionin e veçantë i cili u përcaktua për prokurimet publike (1 pikë) dhe publikoi të dhënat për ofertuesit e përzgjedhur (2 pikë), si dhe për prokurimet publike të realizuara (2 pikë). Mirëpo, opinioni nuk ka qasja tek të dhënat mbi konkuret për prokurimet publike, as në Planin e Prokurimeve Publike dhe Raportin për realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

• SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE

U publikuan të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara gjatë vitit 2019, përveç Buxhetit (2 pikë), propozimet e subjekteve të interesuara në raportet për shqyrtimet publike dhe të dhënat për arsyet e pranimit ose refuzimit të këtyre propozimeve (1+1 pikë). Nuk mund të qasen të dhënat mbi konkuret ose mjetet e ndara për media për vitin 2019, por as informatat mbi konkuret për ndarjen e mjeteve për organizatat e shoqërisë civile për vitin 2019 dhe mënyrën e ndarjes së tyre.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Danillovgradit



GOLLUBOVCI

<http://podgorica.me/opstina-golubovci/>

Komuna Urbane e Gollubovcit, me 22 pikë nga 100 të mundshme, në bazë të indikatorëve të këtij hulumtimi, radhitet në grupin e komunave më pak transparente në Mal të Zi.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 2; Buxheti – 6; Lufta kundër korrupsionit – 2; Qasja e informative – 4; Prokurimet publike – 6; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 2.



Grafiku 15: Vlerësimi sipas fushave i Komunës Urbane të Gollubovcit

Si Komunë Urbane në kuadër të Kryeqytetit, Podgoricës, Komuna e Gollubovcit nuk e ka faqen e vet të internetit, por i publikon informatat, përmes kategorisë së veçantë, në kuadër të faqes së Kryeqytetit. Ky fakt ndoshta ndikon që përdoruesit të kenë qasje më të vështirë në informata, mirëpo duhet theksuar se një numër i konsiderueshëm i të dhënave nuk janë të publikuara, që kërkon adresimin e kësaj çështje nga ana e kompetentëve.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 dokumente të kërkuara në këtë fushë, vetëm një ishte i publikuar – vendimet të cilët i miratoi Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit të Kryeqytetit, më saktësisht në pjesën e cila është e caktuar për Komunen Urbane të Gollubovcit, nuk janë të publikuara amendamentet në propozim

vendimet e shqyrtuara, arsyetimet e këtyre amendamenteve, regjistrat dhe kontaktet e këshilltarëve, votimi i këshilltarëve, krye për emër, gjatë vitit 2019, procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, informatat e transmetimit të seancave plenare të Kuvendit të Komunës në media, rendi i ditës i seancës së ardhshme dhe rezultatet e votimit në këto seanca plenare gjatë vitit 2019.

• BUXHETI

Nga gjithsej 10 dokumente të kërkuara nga fusha e buxhetit, në faqen e internetit ekzistojnë vetëm tre. Në kuadër të arsyetimit të Buxhetit të Kryeqytetit gjendet edhe Buxheti i Komunës Urbane të Gollubovcit (2 pikë) dhe arsyetimi i Buxhetit të Komunës Urbane të Gollubovcit (1 pikë), si dhe Buxheti i Komunës Urbane të Gollubovcit për vitin 2020 (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk u publikua Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik (.xls ose .xlsx), informata se a u shqyrtua Llogaria Përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019, Raporti për Realizimin e Buxhetit, Thirrja Publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019, Informata se a u mbajt shqyrtimi publik dhe raporti nga ai shqyrtim dhe as Udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Kur bëhet fjalë për mekanizmat e luftës kundër korrupsionit, pothuajse nuk ka të dhëna të publikuara. Më saktësisht, nga 14 informata/dokumente të kërkuara, ekziston vetëm Plani i Integritetit për periudhën 2018 – 2020 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekzistojnë informatat për mënyrën e denoncimit të korrupsionit ose opsionit për denoncimin e parregullsive në punën e shërbimeve vendore, raportet ose informatat për numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të proceduara gjatë vitit 2019. Përveç këtyre, nuk u publikuan as informatat për pagat e zyrtarëve dhe funksionarëve, kontakti i personit përgjegjës për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve, Kodeksi Etik për të punësuarit dhe Plani Lokal i Antikorrupsionit për vitin 2019. Gjithashtu, qytetarët nuk kanë qasje as në raportet për realizimin e Planit të Integritetit dhe Planit Lokal të Antikorrupsionit për vitin 2019. Deri në përmbylljen e këtij hulumtimi, kryetari i komunës në kuadër të kryeqytetit nuk e dorëzoi Raportin vjetor të pronës pranë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

• QASJA E INFORMATAVE

Faqja e internetit e Komunës së Gollubovcit ka tre nga 15 informatat/dokumentet e përgjithshme – kontaktin e kryetarit të Komunës (2 pikë), Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës (1 pikë) dhe regjistrin e numrit të të punësuarve në Komunë (1 pikë).

Nuk ka të dhëna për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve, kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale, Planin Strategjik të Zhvillimit të Komunës së Gollubovcit, Planin

vjetor të punës së Komunës dhe Raportit të punës, e as për listën e inspektorateve të Komunës. Nuk është afishuar orari për pranimin tek kryetari i Komunës dhe as orari i punës i Komunës, ndërsa mungojnë të dhënat për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike. Po ashtu, nuk u publikua Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata, regjistri i informatave të lejuara sipas Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata, e as kontakti i personit i cili merr vendimet sipas kërkesave për qasjen e lirë në informata.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Gollubovcit u publikuan të dhënat mbi konkurset për prokurimet publike (2 pikë), të dhënat për ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë) dhe për prokurimet publike të realizuara në vitin 2019 (2 pikë). Nuk ka seksion të veçantë të përcaktuar për prokurimet publike, ndërsa nuk u publikuan Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 dhe Raporti për realizimin e Planit për Prokurimet Publike për vitin 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Në këtë fushë, u publikuan konkurset për organizatat e shoqërisë civile dhe rezultatet e këtyre konkurseve (1+1 pikë), mirëpo nuk ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara gjatë vitit 2019, përveç shqyrtimit publik për Buxhetin, raportet nga shqyrtimet publike me të dhënat për propozimet e subjekteve të interesuara dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve dhe as të dhëna që përfshijnë mjetet e ndara për media në vitin 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës Urbane të Gollubovcit


22
pikë

GUCI

www.opstinagusinje.me

Komuna e Gucisë, sipas parametrave të këtij hulumtimi, mbanë vlerësimin më të dobët në aspektin e transparencës së vetëqeverisjeve vendore në Mal të Zi me gjithsej 19 pikë.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 2; Buxheti - 6; Lufta kundër korrupsionit - 4; Qasja e informatave - 4; Prokurimet publike - 1; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike - 2.



Grafiku 16: Vlersëimi sipas fushave i Komunës së Gucisë

Një nga Komunitatet më të reja në Mal të Zi karakterizohet nga jotransparenca e theksuar në aspektin e qasshmërisë së informatave me rëndësi për mbikqyrtjen e politikave publike, por edhe për nevojat e qytetarëve dhe qytetareve.

• KUVENDI I KOMUNËS

Në faqen e internetit të Komunës së Gucisë, në pjesën e informatave që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit të Komunës, nga 10 dokumente/informata të kërkuara u publikuan të dhënat për këshilltarët, përkatësisht lista e tyre (2 pikë).

Nuk ekzistojnë vendimet e miratuara në Kuvendin e Komunës, rezultatet e votimeve ose votat individuale të këshilltarëve, por as amendamentet në propozim vendimet dhe arsyetimet e amendamenteve të dorëzuara. Përveç këtyre, nuk u publikua rendi i ditës i seancave plenare

të Kuvendit të Komunës, të dhënat kontaktuese të këshilltarëve, procesverbalet nga seancat plenare të Kuvendit të Komunës, por as informatat mbi transmetimin e drejtpërdrejtë përmes mediave.

• BUXHETI

Në faqen e internetit të Komunës së Gucisë, nga 10 informata/dokumente të kërkuara e që kanë të bëjnë me buxhetin, qytetarët kanë qasje në katër sosh – Buxhetin për vitin 2019 (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë), informata se u mbajt shqyrtimi publik për Buxhetin e vitit 2019 (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë).

Në këtë faqe nuk ekziston arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, as Buxheti në formën e lexueshme mekanike. Gjithashtu, nuk u publikuan Raporti i shqyrtimit publik për Buxhetin e vitit 2019, Raporti për realizimin e këtij Buxheti, Udhëzuesi i Buxhetit për qytetarët dhe qytetaret, si dhe Llogaria përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në pjesën e luftës kundër korrupsionit, Komuna e Gucisë e publikoi në faqen e vet vetëm Planin e Integritetit (2 pikë). Po ashtu, kryetarja e Komunës e dorëzoi Raportin e pasurisë për vitin 2019 (2 pikë) pranë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Qytetarët dhe qytetaret nuk kanë qasje në informatat për mekanizmat e denoncimit të korrupsionit, as në opsionet e denoncimit të parregullsisve, gjegjësisht të shkeljeve të ligjit nga shërbimet e Komunës, e si rrjedhojë nuk u përcaktuan as mundësitë që denoncimi të bëhet në mënyrë anonime. Po ashtu, nuk ka as raporte ose informata rreth numrit të denoncimeve të dorëzuara dhe të procedura gjatë vitit 2019. Përveç këtyre, në faqen e internetit nuk u publikua Kodeksi Etik për të punësuarit, Raporti për realizimin e Planit të Integritetit, Planit Lokal të Antikorrupsionit, Raporti për realizimin e Planit Lokal të Antikorrupsionit, të dhënat për pagat e funksionarëve dhe zyrtarëve, e as informata për personin e emëruar për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Në aspektin e qasjes së informatave/dokumenteve të përgjithshme, nga 15 dokumente/informata të kërkuara në faqen e internetit janë vetëm tre sosh – lista e inspektorateve të Komunës që janë pjesë e Policisë Komonale (1 pikë), kontakti i kryetares së Komunës (2 pikë) dhe regjistri i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk u publikuan të dhënat për orarin e punës të kësaj Komune, orarin e pranimit të qytetarëve dhe qytetareve tek kryetarja e Komunës, e as kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale. Po ashtu, nuk janë informatat për të vepruarit në bazë të ankesave dhe vërejtjeve, nuk u publikuan Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës, Plani Strategjik i Komunës, Plani Vjetor i Punës dhe Raporti i Punës, por as të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë dhe në institucionet dhe ndërmarrjet e saja. Qytetarët dhe qytetaret nuk kanë qasje as në Udhëzuesin për Qasjen e Lirë të

Informatave dhe as në kontaktin e personit që merr vendimet në bazë të kërkesave për qasje të lirë në informata.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Komuna e Gucisë në faqen e vet të internetit ka seksionin e veçantë të përcaktuar për prokurimet publike (1 pikë). Mirëpo, në të njëjtën faqe nuk u publikuan të dhënat mbi konkurset për prokurimet publike, për ofertuesit e zgjedhur, por as Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019, Raporti për realizimin e Planit të Prokurimeve Publike ose të dhënat për prokurimet publike të realizuara.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Sa i përket shqyrtimeve publike dhe konkurseve publike, Komuna e Gucisë në faqen e vet të internetit publikoi vetëm të dhënat mbi konkurset për ndarjen e mjeteve për OJQ-të dhe rezultatet e këtyre konkurseve (1+1 pikë). Nuk u publikuan të dhënat për shqyrtimet publike gjatë vitit 2019, raportet nga shqyrtimet publike të cilët përmbajnë propozimet dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre, e as të dhënat rreth konkurseve për media ose për mjetet e ndara për media gjatë vitit 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm
për Komunën e Gucisë


19
pikë

HERCEG NOVI

www.hercegnovi.me

Komuna e Herceg Novit me gjithsej 47 pikë, sipas indikatorëve të definuar të këtij hulumtimi, u pozicionua lartë në renditjen e komunave me transparencë të mesme.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 5; Buxheti – 7; Lufta kundër korrupsionit – 7; Qasja e informative – 15; Prokurimet publike – 9; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 4.



Grafiku 17: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Herceg Novit

Faqja e internetit e Komunës së Herceg Novit është e pëlqyeshme, e qartë dhe e kthyer kah përdoruesit. Disa fusha u mbuluan mirë nga ana përmbajtjesore, gjersa në disa të tjera mungojnë një pjesë e konsiderueshme e informatave që janë të rëndësishme për mbikëqyrjen e politikave publike.

• KUVENDI I KOMUNËS

Në faqen e internetit të Komunës së Herceg Novit u publikuan vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), lista e këshilltarëve (2 pikë) dhe informata për transmetimin e drejtpërdrejtë përmes mediave (1 pikë).

Mirëpo, nuk ekzistojnë rezultatet e votimit në seancat plenare të Kuvendit të Komunës, informatat se si votuan këshilltarët krye për emër, cilët amendamente u propozuan në propozim vendimet dhe si u arsyetuan ato, procesverbalet nga seancat e Kuvendit

të Komunës, të dhënat kontaktuese të këshilltarëve, e as rendi i ditës i mbledhjes së Kuvendit të Komunës.

• BUXHETI

Në pjesën e administrimit buxhetor, në faqen e internetit të Komunës së Herceg Novit u publikua Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), pastaj Raporti për realizimin e këtij buxheti (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë) dhe informata se u mbajt shqyrtimi publik (2 pikë).

Nga ana tjetër, nuk ekziston arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, Buxheti në formën e lexueshme mekanike, Udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret, Raporti nga shqyrtimi publik për Buxhetin e vitit 2019, Informata se a u shqyrtua Llogaria përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019, por as Buxheti i vitit 2020.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Komuna e Herceg Novit në faqen e vet ka opsionin ku qytetarët dhe qytetaret mund të denoncojnë parregullsitë dhe shkeljet e ligjit në formën e sistemit 48h (2 pikë), Kodeksin Etik për të punësuarit (2 pikë) dhe Informatat për pagat e funksionarëve (1 pikë). Kryetari i Komunës e dorëzoi Raportin e pasurisë për vitin 2019 (2 pikë).

Nuk ekziston të dhënat e hollësishme për mekanizmat e denoncimit të korrupsionit në Komunë, nuk ekziston opsioni ku denoncimi i parregullsive dhe i shkeljeve të ligjit mund të bëhet në mënyrë anonime, e nuk ekziston as raporti ose informata mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe proceduara gjatë vitit 2019. Përveç këtyre, në faqen e internetit nuk u publikuan Plani i Integritetit, Plani Lokal i Antikorrupsionit, raportet për realizimin e tyre, ndërsa nuk u publikuan as të dhënat për pagat e zyrtarëve dhe as kontakti i personit i cili shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Në fushën e cila ka të bëjë me qasjen e përgjithshme të informatave/dokumenteve, u konstatua shkalla më e lartë e transparencës. Komuna e Herceg Novit e ka të afishuar qartë orarin e punës (2 pikë), të dhënat kontaktuese të kryetarit të Komunës (2 pikë) dhe të kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë). Ka të publikuar listën e inspektorateve të Komunës në kuptimin e Policisë Komonale (1 pikë), të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë (1 pikë), Udhëzuesin për qasjen e lirë në informata (2 pikë), regjistrin e informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontaktin e personit i cili merr vendime sipas kërkesave për qasjen e lirë të informatave (2 pikë).

Në faqe nuk ka informata për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve dhe për oraret e përcaktuara për pranimin e qytetarëve dhe qytetareve tek kryetari i Komunës, ndërsa nuk ekzistojnë Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës, të dhënat për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës, Plani Vjetor i Punës së Komunës dhe Raporti i Punës së vetëqeverisjes vendore.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Faqja e internetit e Komunës së Herceg Novit e ka seksionin e dedikuar për prokurimet publike (1 pikë), të dhënat për konkurset e prokurimeve publike (2 pikë), prokurimet publike të realizuara (2 pikë), ofertuesit e përzgjedhur (2 pikë), si dhe Planin e Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë). E vetmja gjë që nuk u publikua është Raporti për Realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Në faqe e internetit ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike (2 pikë), u publikuan konkurset publike për ndarjen e mjeteve OJQ-ve gjatë vitit 2019 (1 pikë) dhe rezultatet e këtyre konkurseve (1 pikë). Nuk ka të dhëna për propozimet e subjekteve të interesuara gjatë shqyrtimeve publike, arsyeve për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve, as për konkurset për ndarjen e mjeteve për mediat dhe rezultatet e këtyre konkurseve.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Herceg Novit


47
pikë

KOLLASHIN

www.opstinakolasin.me

Komuna e Kollashinit 45 nga 100 pikë të mundshme, që e pozicion lartë në renditjen e komunave me transparencë të mesme.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 6; Buxheti – 5; Lufta kundër korrupsionit – 12; Qasja e informative – 16; Prokurimet publike – 3; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 3.



Grafiku 18: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Kollashinit

Duhet të theksojmë se pas përfundimit të këtij hulumtimi u vërejt se Komuna e Kollashinit krijoi faqen e re të internetit, e cila duket shumë më e avancuar nga faqja paraprake, mirëpo ajo nuk ishte temë e analizës sepse ky vlerësim i transparencës është për vitin 2019.

• KUVENDI I KOMUNËS

Në këtë pjesë, nga 10 informata/dokumente të kërkuara, të publikuara ishin vetëm tre – informata për vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës i seancës së ardhshme (2 pikë) dhe lista e këshilltarëve (2 pikë).

Mirëpo, nuk u publikuan rezultatet e votimit në seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019 dhe as votat individuale të këshilltarëve. Po ashtu, nuk

ekzistojnë amendamentet në propozim vendimet e shqyrtuara në seancat plenare dhe as arsyetimet e këtyre amendamenteve. Në fund, qytetarët nuk kanë qasje as në procesverbalet nga mbledhjet dhe kontaktet e këshilltarëve, si dhe nuk informohen për transmetimin direkt përmes mediave.

• BUXHETI

Në faqen e internetit të Komunës së Kollashinit u publikuan Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), Udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret (1 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin (1 pikë) dhe Buxhetin për vitin 2020 (1 pikë).

Nuk ekziston arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019 dhe as nuk ekziston Buxheti në formën e lexueshme mekanike. Po ashtu, nuk u publikuan as Raporti për realizimin e Buxhetit për vitin 2019, të dhënat për mbajtjen e shqyrtimit publik për Buxhet dhe për Llogarinë përfundimtare të Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Faqja e internetit e Komunës së Kollashinit përmban informatat mbi mekanizmat e denoncimit të korrupsionit (2 pikë), ndërsa ekziston edhe opsioni i denoncimit të parregullsive dhe i shkeljeve të ligjit nga ana e shërbimeve lokale (2 pikë) dhe mundësia që kjo gjë të bëhet në mënyrë anonime (1 pikë). Përveç këtyre, u publikua edhe Plani i Integritetit (2 pikë), Informata për pagat e funksionarëve (1 pikë), si dhe emri i personit i cili shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve (2 pikë). Po ashtu, kryetari i Komunës e dorëzoi Raportin e pasurisë për vitin 2019 (2 pikë).

Nuk ekziston raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara ose proceduara gjatë vitit 2019, Kodeksin Etik për të punësuarit, Raportin për realizimin e Planit të Integritetit, Planin Lokal të Antikorrupsionit dhe as raporti për realizimin e tij, por as informata për pagat e zyrtarëve.

• QASJA E INFORMATAVE

Sa i përket informatave të përgjithshme, u afishua orari i punës i Komunës (2 pikë), ndërsa ekzistojnë edhe kontakti i Kryetarit të Komunës (2 pikë) dhe kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë), lista e inspektorateve të Komunës përveç Policisë Komonale dhe Inspektoratit Komunal (1 pikë), Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës (1 pikë), Plani Vjetor i Punës së Komunës (1 pikë), numri i të punësuarve në Komunë (1 pikë), Udhëzuesi për Qasjen e Lirë të Informatave (2 pikë), informatat e lejuara sipas Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontakti i personit i cili merr vendimeve sipas këtyre kërkesave (2 pikë).

Në faqe nuk ekzistojnë të dhënat për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve, si dhe u afishua orari i pranimeve tek kryetari i Komunës. Po ashtu, nuk u publikua Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës, Raporti i Punës së Komunës dhe as numri i të punësuarve në ndërmarrjet dhe institucionet publike.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Kollashinit ekziston seksioni për prokurimet publike (1 pikë) dhe Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë). Mirëpo, në faqe nuk u publikuan konkurset për prokurimet publike, të dhënat për prokurimet publike të realizuara dhe për ofertuesit e përzgjedhur, por as Raporti për Realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Në faqen e internetit ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet e mbajtura publike gjatë vitit 2019 (2 pikë), ndërsa u publikuan edhe konkurset publike për ndarjen e mjeteve organizatave të shoqërisë civile gjatë vitit 2019 (1 pikë).

Nuk u publikuan të dhënat për propozimet e subjekteve të interesuara, arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve, rezultatet e konkursit për organizatat e shoqërisë civile, por as konkurset për media dhe rezultatet e këtyre konkurseve.

Vlerësimi i përgjithshëm për
Komunën e Kollashinit


45
pikë

KOTORR

www.kotor.me

Komuna e Kotorrit, sipas indikatorëve të përcaktuar me këtë hulumtim, bënë pjesë në kategorinë e komunave më transparente malazeze me gjithsej 53 pikë të fituara.

Sipas fushave, ndarja e pikëve vijon si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 7; Buxheti – 6; Lufta kundër korrupsionit – 10; Qasja e informative – 14; Prokurimet publike – 9; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 7.



Grafiku 19: Vlerësimi i përgjithshëm i Komunës së Kotorrit

Komuna e Kotorrit edhe në hulumtimet e mëparshme të transparencës së komunave malazeze, të cilat i realizoi Qendra për Arsimim Qytetarë, kishte nivel solid të transparencës dhe ky trend u vazhdu. Mirëpo, ekziston hapësira për përmirësime në pjesën e qasshmërisë së dokumenteve/informatave të cilat mundësojnë mbikëqyrjen adekuate të politikave publike në këtë Komunë.

• KUVENDI I KOMUNËS

Në faqen e internetit të Komunës së Kotorrit ekzistojnë informatat për vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës i seancës së ardhshme plenare (2 pikë), lista e këshilltarëve (2 pikë), si dhe informata për transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave të Kuvendit të Komunës përmes mediave lokale (1 pikë).

Mirëpo, nuk ekzistojnë të dhënat për rezultatet e votimit në seancat e Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019 dhe as për votat individuale të këshilltarëve. Po ashtu, nuk u publikuan amendamentet në propozim vendimet e shqyrtuara në seancat plenare dhe as arsyetimet e këtyre amendamenteve. Në fund, nuk u publikuan procesverbalet nga seancat e Kuvendit të Komunës dhe as kontaktet e këshilltarëve.

• BUXHETI

Në pjesën e cila ka të bëjë me çështjet buxhetore, në faqen e internetit të Komunës së Kotorrit u publikua Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik të Buxhetit të vitit 2019 (1 pikë), Informata se u mbajt shqyrtimi publik i Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë), si dhe Buxheti për vitin 2020 (1 pikë).

Nuk ekziston arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, Buxheti në formën e lexueshme mekanike dhe as raporti për realizimin e Buxhetit. Përveç kësaj, nuk ekzistojnë udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret, Raporti nga shqyrtimi i mbajtur publik dhe as Llogaria përfundimtare për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Komuna e Kotorrit i publikoi gjashtë nga 13 informata/dokumente të kërkuara në pjesën e cila ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit. Është me rëndësi që kjo Komunë në faqen e vet të internetit e ka opsionin që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljet e ligjit përmes sistemit 48h (2 pikë), si dhe që ekziston mundësia e denoncimit anonim (1 pikë). Po ashtu, u publikua Kodeksi Etik për të punësuarit (2 pikë), Plani i Integritetit (2 pikë), Informata për pagat e funksionarëve (1 pikë), ndërsa kryetari i Komunës e dorëzoi raportin e pasurisë për vitin 2019 (2 pikë).

Mirëpo, në faqe nuk ekzistojnë mekanizmat për denoncimin e korrupsionit, raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara ose të proceduara gjatë vitit 2019, Raporti për realizimin e Planit të Integritetit, Plani Lokal i Antikorrupsionit dhe raporti për realizimin e tij, Informatat për pagat e zyrtarëve, por as kontakti i personit i cili shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve.

• QASAJ E INFORMATAVE

Sa i përket informatave të përgjithshme, në faqe ekzistojnë të dhënat për orarin e punës (1 pikë), lista e inspektorateve të Komunës (2 pikë), të dhënat e të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve përmes sistemit 48h (1 pikë), kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë) dhe i kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë). Përveç kësaj, ekziston edhe regjistri i të punësuarve në Komunë (1 pikë), si dhe Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata (1 pikë) së bashku me regjistrin e informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontaktin e personit i cili merr vendimet në bazë të këtyre kërkesave (2 pikë).

Nuk u definua orari i pranimi për qytetarët dhe qytetaret tek kryetari i Komunës, ndërsa në faqen e internetit nuk ekziston Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunës, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës, Plani Vjetor i Punës dhe Raporti i Punës së Komunës dhe as të dhënat për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Kotorrit ekziston seksioni për prokurimet publike (1 pikë), ndërsa u publikuan të dhënat rreth konkurseve për prokurimet publike (2 pikë), prokurimet publike të realizuara (2 pikë), ofertuesit e përzgjedhur (2 pikë), si dhe Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë). Mirëpo, në ueb faqe nuk u publikua Raporti për Realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Në faqe e internetit ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara (2 pikë), raporti për shqyrtimet publike të cilët përbëjnë propozimet e subjekteve të interesuara (2 pikë), rezultatet e konkursit për ndarjen e mjeteve OJQ-ve dhe mediave (1+1 pikë), si dhe konkursi publik për ndarjen e mjeteve për OJQ-të gjatë vitit 2019 (1 pikë). Nuk ekzistojnë të dhënat mbi arsyet e pranimi ose refuzimit të propozimeve që u dhanë në shqyrtimet publike, si dhe konkurset për ndarjen e mjeteve për mediat.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Kotorrit




MOJKOVAC

www.mojkovac.me

Komuna e Mojkovacit, sipas indikatorëve të këtij hulumtimi, u pozicionua lartë në kategorinë e komunave malazeze me transparencë të mesme, me gjithsej 45,5 pikë.

Sipas fushave, ndarja e pikave është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 6; Buxheti – 10; Lufta kundër korrupsionit – 7; Qasja e informatave – 7; Prokurimet publike – 9; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 6,5.



Grafiku 20: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Mojkovacit

Faqja e internetit e Komunës së Mojkovacit u inovua në krahasim me periudhën e mëparshme, është më e qartë dhe e kthyer kah përdoruesit. Mirëpo, në pjesën përmbajtjesore nevojiten përmirësimet, dhe atë në të gjitha fushat e analizuar.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga gjithsej 10 informata/dokumente të hulumtuara në këtë pjesë, në faqen e internetit të Komunës së Mojkovacit ekzistojnë tre – vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës së seancës së ardhshme plenare (2 pikë) dhe lista e këshilltarëve (2 pikë).

Nuk u publikuan rezultatet e votimit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019 dhe as si votoi çdo këshilltarë. Po ashtu, nuk u publikuan amendamentet në

propozim vendimet e shqyrtuara në seanca plenare, arsyetimet e këtyre amendamenteve, procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, kontaktet e këshilltarëve, dhe as informatat se a ka transmetim të drejtpërdrejtë të seancave plenare.

• BUXHETI

Komuna e Mojkovacit mundësoi qasjen e Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë), Raportin për realizimin e Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë), Thirrjen publike për shqyrtimin publik të Buxhetit për vitin 2019 (1 pikë), Informatën se u mbajt shqyrtimi publik për Buxhetin (2 pikë), Raportin e këtij shqyrtimi publik (2 pikë) si dhe Buxhetin për vitin 2020 (1 pikë).

Mirëpo, nuk u publikua arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, as Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik, Udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret dhe as Llogaria përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Komuna e Mojkovacit mundësoi qasjen e katër nga 13 informata/dokumente të kërkuara në pjesën e luftës kundër korrupsionit. Këtu hynë Kodeksi Etik për të punësuarit (2 pikë), Plani i Integritetit (2 pikë), kontakti i personit i cili shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve (2 pikë), si dhe Raporti i pasurisë i kryetarit të Komunës për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekzistojnë të dhënat mbi mekanizmat e denoncimit të korrupsionit në komunën e Mojkovacit, opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë dhe shkeljet e ligjit të shërbimeve komunale, raportin ose informatën për numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe proceduara gjatë vitit 2019, Raporti për realizimin e Planit të Integritetit, Plani Lokal i Antikorrupsionit dhe Raporti për realizimin e tij dhe as informatat për pagat e funksionarëve dhe zyrtarëve.

• QASJA E INFORMATAVE

Kur bëhet fjalë për qasjen e informatave të përgjithshme, në faqen e internetit ekzistojnë: kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë), Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës së Mojkovacit (2 pikë), regjistri i të punësuarve në Komunë (1 pikë) dhe kontakti i personit i cili merr vendime sipas kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Mirëpo, nuk u afishua orari i punës i Komunës, lista e inspektorateve të Komunës, kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale dhe as nuk u përcaktua orari i pranimeve të qytetarëve dhe qytetareve tek kryetari i Komunës. Po ashtu, në ueb faqe nuk janë: Udhëzuesi për Qasjen e Lirë të Informatave, regjistri i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë të Informatave, Rregullorja e organizimit dhe sistematizimit të brendshëm të vendeve të punës në Komunë, Plani Vjetor i Punës dhe Raporti i Punës së Komunës dhe të dhënat për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Mojkovacit ekziston seksioni për prokurimet publike (1 pikë) dhe u publikuan të dhënat mbi konkursin për prokurimet publike (2 pikë), së bashku me të dhënat për prokurimet publike të realizuara (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë), si dhe Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë). Në ueb faqe nuk është vetëm Raporti për realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Në ueb faqe ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara (2 pikë), raportet nga shqyrtimet publike të cilët përmbajnë propozimet e subjekteve të interesuara (por vetëm në disa shqyrtime publike që u mbajtën kohët e fundit) që rezultojë me numrin më të ulët të pikëve (0,5 pikë). Raportet përmbajnë informatën për arsyet e pranimit ose mospranimit të propozimeve (2 pikë), ndërsa u publikuan edhe konkurset dhe rezultatet e konkurseve për ndarjen e mjeteve OJQ-ve (1+1 pikë). Nuk ekzistojnë të dhënat për ndarjen e mjeteve për mediat.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Mojkovacit


45.5
pikë

NIKSHIQ

www.nikšić.me

Komuna e Nikshiqit është një nga komunat malazeze më transparente me gjithsej 54 pikë.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 9, Buxheti – 5, Lufta kundër korrupsionit – 9, Qasja e informatave – 14, Prokurimet publike – 9, Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 8.



Grafiku 21: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Nikshiqit

Komuna e Nikshiqit është e treta në renditje, në bazë të parametrave të këtij hulumtimi, por shuma e pikëve, e cila është pak mbi gjysmën e pikëve të mundshme, tregon për nevojën e përmirësimit të përmbajtjes në faqen e internetit, në pjesën e publikimit të dokumenteve/informatave të cilët mund të kontribuojnë për vlerësimin e politikave të cilat i zbaton vetëqeverisja vendore.

• KUVENDI I KOMUNËS

Sa i përket informatave/dokumenteve të kërkuara e që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit të Komunës, në ueb faqe janë të publikuara vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rezultatet e votimeve nga seancat plenare (1 pikë), rendi i ditës në seancën e ardhshme plenare (2 pikë), lista e këshilltarëve (2 pikë), procesverbalet nga mbledhjet (1 pikë), si dhe informatat për transmetimet e

drejtpërdrejta të Kuvendit të Komunës (1 pikë).

Nuk u publikuan rezultatet e votimeve individuale të këshilltarëve, amendamentet në propozim vendimet e shqyrtuara në seancat plenare dhe as arsyetimet e këtyre amendamenteve dhe as kontaktet e këshilltarëve.

• BUXHETI

Nga gjithsej 10 informata/dokumente që kanë të bëjnë me Buxhetin, u publikuan vetëm katër – Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019 (1 pikë), raporti për realizimi e buxhetit (2 pikë) dhe Buxheti për vitin 2020 (1 pikë).

Nga ana tjetër, nuk u publikuan: Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik, Udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret, Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019, informata se a u mbajt shqyrtimi publik, Raporti nga shqyrtimi publik, si dhe Llogaria përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në faqen e internetit të Komunës së Nikshiqit u publikuan: Kodeksi Etik për të punësuarit (2 pikë), Plani i Integritetit (2 pikë), Plani Lokal i Antikorrupsionit (2 pikë), Informatat për pagat e funksionarëve (1 pikë), ndërsa kryetari i Komunës e dorëzoi Raportin e pasurisë për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqe nuk ekzistojnë mekanizmat për denoncimin e korrupsionit, nuk ekziston opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë dhe shkeljet e ligjit, e si rrjedhojë as mundësia e denoncimit anonim. Po ashtu, nuk ekziston raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara ose të proceduara për vitin 2019, Raporti për realizimin e Planit të Integritetit dhe Planit Lokal të Antikorrupsionit, Informata për pagat e funksionarëve dhe zyrtarëve, si dhe kontakti i personit i cili shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Ndër informatat e përgjithshme, në faqen e internetit të Komunës së Nikshiqit u publikua lista e inspektorateve të Komunës së bashku me kontaktet e shërbimit për punë inspektuese (2 pikë), kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë), Plani Strategjik i Zhvillimit (2 pikë), Plani Vjetor i Punës (1 pikë), të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë (1 pikë), Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë), informatat e lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontakti i personit i cili merr vendimet në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Mirëpo, nuk u afishua orari i punës dhe as nuk u përcaktua orari i pranimeve të qytetarëve dhe qytetareve tek kryetari i Komunës. Po ashtu, nuk ka informata për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve dhe as nuk u publikua Rregullorja për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës, Raporti për Punën e Komunës në vitin 2019 dhe të dhënat për të punësuarit në institucionet dhe ndërmarrjet publike.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e Komunës së Nikshiqit ekziston seksioni për prokurime publike (1 pikë) dhe u publikuan të dhënat për konkursin e prokurimeve publike (2 pikë), së bashku me të dhënat për prokurimet publike të realizuara (2 pikë) dhe për ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë), si dhe Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë). Raporti për realizimin e Planit të Prokurimeve Publike nuk është qasshëm në këtë ueb faqe.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Nikshiqit u publikuan të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara (2 pikë), Raportet nga shqyrtimet publike (2 pikë), e të cilët përmbajnë informatën për arsyet e pranimit ose refuzimit të propozimeve (2 pikë). Po ashtu, u publikua konkursi dhe rezultatet e konkursit për ndarjen e mjeteve organizatave të shoqërisë civile (1+1 pikë). Nuk ka të dhëna për mjetet e ndara për media.

Vlerësimi përgjithshëm i
Komunës së Nikshiqit


54
pikë

PETNICË

www.petnjica.co.me

Komuna e Petnicës me gjithsej 33 pikë, të fituara në bazë të indikatorëve të këtij hulumtimi, radhitet ndër komunat me transparencë të mesme.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 4, Buxheti – 7, Lufta kundër korrupsionit – 5, Qasja e informatave – 6, Prokurimet publike – 7, Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 4.



Grafiku 22: Vlerësimi i përgjithshëm i Komunës së Petnicës

Nga 10 dokumente të kërkuara që kanë të bëjnë me funksionimin e Kuvendit të Komunës, në faqen e internetit të Komunës së Petnicës ishin vetëm 2 – vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë) dhe regjistri i këshilltarëve (2 pikë).

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 dokumente të kërkuara që kanë të bëjnë me funksionimin e Kuvendit të Komunës, në faqen e internetit të Komunës së Petnicës ishin vetëm 2 – vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë) dhe regjistri i këshilltarëve (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk ishte e mundur gjetja e rezultateve të votimit në seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019, pastaj se si votuan këshilltarët krye për emër në seancat gjatë të njëjtit vit, amendamentet e dorëzuara në propozim aktet e shqyrtuara së bashku me arsyetimet e këtyre amendamenteve, e as rendi i ditës nga seanca e ardhshme, procesverbali nga seanca e Kuvendit të Komunës, kontaktet e këshilltarëve dhe as informatat se a transmetohen seancat përmes ndonjërit nga mediat lokale.

• BUXHETI

Sa i përket çështjeve buxhetore, prej gjithsej 10 dokumente të kërkuara, në faqen e internetit të kësaj komune u publikuan katër – Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), Raporti për realizimin e Buxhetit (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik të buxhetit për vitin 2019 (1 pikë) dhe Informata se u mbajt shqyrtimi publik i Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë).

Në ueb faqe nuk ishte arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019 dhe as ky Buxhet në formatin e lexueshëm mekanik (.xls ose .xlsx), por është vetëm në formatin PDF. Po ashtu, nuk ekzistojnë as: Udhëzuesi për qytetarët dhe qytetarët, Informata se a u shqyrtua Llogaria përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019, Raportin për realizimin e shqyrtimit publik dhe as Buxheti i vitit 2020.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në aspektin e luftës kundër korrupsionit, nga 14 informata/dokumente të kërkuara, të publikuara janë vetëm tre – Kodeksi Etik për të punësuarit (2 pikë), Informata për pagat e Funkionarëve (1 pikë) dhe Raporti për pasurinë e kryetarit të Komunës për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekzistojnë mekanizmat për denoncimin e korrupsionit dhe as opsioni që qytetarët dhe qytetarët të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljet e ligjit, e si rrjedhojë nuk ekziston as mundësia e denoncimit anonim. Nuk është i publikuar as raporti ose informata mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara ose të proceduara gjatë vitit 2019, Plani i Integritetit për periudhën 2018 – 2020, Plani Lokal i Antikorrupsionit dhe as Raportet për realizimin e tyre. Përveç këtyre, nuk u publikuan as informatat për pagat e zyrtarëve dhe as kontakti i personit të emëruar për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Nga 15 informata/dokumente të kërkuara, në faqen e internetit të Komunës së Petnicës janë vetëm tre – kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë), pasqyrimi i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontakti i personit që merr vendimet në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Nuk ekzistojnë të dhënat për orarin e punës të vetëqeverisjes vendore dhe as nuk është afishuar orari për pranimin tek kryetari i Komunës. Nuk u publikua lista e inspektorateve të Komunës, as të dhënat për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve,

të dhënat për kryetarët e bashkësive lokale. Mungojnë edhe Plani vjetor i punës së Komunës, Raportin i Punës për vitin 2019, të dhënat për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike, Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës, Plani Strategji i Zhvillimit të Komunës dhe të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë. Ekziston kategoria Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata mirëpo pa informata kur i klikojmë në këtë opsion.

• PROKURIMET PUBLIKE

Në faqen e Komunës së Petnicës ekziston seksioni i prokurimeve publike (1 pikë) me të dhënat për konkurset e publikuara për prokurimet publike (2 pikë), prokurimet publike të realizuara gjatë vitit 2019 (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë). Në faqe e internetit nuk u publikua Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 dhe as Raporti për realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

• SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE

Ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike të mbajtura gjatë vitit 2019 (2 pikë), ndërsa në faqen e internetit janë publikuar edhe konkurset për ndarjen e mjeteve organizatave të shoqërisë civile për vitin 2019 (1 pikë), si dhe vendimet për mënyrën e ndarjes së tyre (1 pikë). Mirëpo, raportet e shqyrtimeve publike së bashku me propozimet e subjekteve të interesuara dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre nuk u publikuan, njëjtë sikur nuk u publikuan as mjetet e ndara për media gjatë vitit 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Petnicës


33
pikë

PLAVË

www.plav.me

Komuna e Plavës, në bazë të parametrave të definuara me këtë hulumtim, me gjithsej 25 pikë radhitet ndër komunitat më pak transparente në Mal të Zi.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 4, Buxheti – 8, Lufta kundër korrupsionit – 3, Qasja e informatave – 4, Prokurimet publike – 3, Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 4.



Grafiku 23: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Plavës

Iako je sajt opštine Plav napravljen tako da izgleda vizuelno primječiv i jednostavan za korisnike, ozbiljne su manjkavosti u sadržaju kad se provjere određene kategorije. Neophodna su unaprijeđenja kako se bi se olakšao pristup građanima i građankama u dijelu korišćenja servisa, ali i efektivno praćenje rada lokalne samouprave.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga gjithsej 10 dokumente të kërkuara të cilët kanë të bëjnë me Kuvendin e Komunës, vetëm dy janë të publikuara – rendi i ditës i seancës së ardhshme të Kuvendit të Komunës (2 pikë) dhe lista e këshilltarëve (2 pikë).

Nuk janë të postuara vendimet e Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019, votimet nga seancat plenare gjatë të njëjtës periudhë dhe as si kanë votuar këshilltarët veç e veç. Po ashtu, nuk janë të publikuara amendamentet në propozim aktet që u shqyrtuan në seancat plenare dhe as arsyetimet e këtyre amendamenteve. Publiku nuk ka qasje as në kontaktet e këshilltarëve, procesverbalet nga seancat plenare dhe as në informatat për transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në mediat lokale.

• BUXHETI

Në këtë fushë, nga 10 informata/dokumente të kërkuara, në faqen e internetit është i postuar Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin (1 pikë), Informata se u mbajt shqyrtimi publik për Buxhetin e vitit 2019 (2 pikë), Raporti nga ky shqyrtim publik (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë).

Mirëpo, në faqen e internetit nuk gjenden: arsyetimi i Buxhetit, Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik dhe as raporti për realizimin e Buxhetit, Udhëzuesi për qytetarët dhe qytetarët dhe Llogaria përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Edhe sa i përket luftës kundër korrupsionit ekziston mangësia serioze e informatave. Prej 14 informata/dokumente të kërkuara, vetëm tre janë të publikuara në ueb faqe: opsioni që qytetarët dhe qytetarët të denoncojnë parregullsitë në punën e Komunës (2 pikë), Plani i Integritetit (1 pikë) dhe Raporti për pasurinë e Kryetarit të Komunës për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekzistojnë informatat mbi mekanizmat e denoncimit të korrupsionit dhe as mundësia e denoncimit anonim. Përveç këtyre, nuk ekziston as raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara ose të procedura për vitin 2019, Plani i Integritetit dhe Plani Lokal i Antikorrupsionit dhe as raporti për realizimin e tyre. Po ashtu, nuk u publikuan as informatat për pagat e funksionarëve ose zyrtarëve dhe as kontakti i personit i cili shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Kur bëhet fjalë për informatat e përgjithshme, në faqen e internetit të Komunës së Plavës gjendet lista e inspektorateve të Komunës (1 pikë), kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë) dhe kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë), Plani i Punës së Komunës (1 pikë) dhe regjistri i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (1 pikë).

Nga ana tjetër, ka tejet më shumë informata të cilat nuk janë publikisht të qasshme. Këtu hyjnë të dhënat për orarin e punës së Komunës, të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve, informata për oraret e pranimit të qytetarëve dhe qytetareve tek kryetari i Komunës, Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës, Raporti i Punës, Informata për

numrin e të punësuarve në Komunë dhe në institucionet dhe ndërmarrjet e saja publike, pastaj Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata dhe kontakti i personit i cili merr vendimet në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Plavës ekziston seksioni për prokurimet publike (1 pikë) me të dhënat për konkurset e shpallura të prokurimeve publike (2 pikë), prokurimet publike të realizuara në vitin 2019 (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë). Po ashtu, u publikua edhe Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë), por nuk u publikua Raporti për Realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Komuna e Plavës, në pjesën e shqyrtimeve publike dhe konkurseve publike, publikoi të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara (2 pikë), të dhënat për propozimet e subjekteve të interesuara në shqyrtimet publike (2 pikë), si dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre (2 pikë). Faqja e internetit e Komunës së Plavës nuk përmban konkurset për ndarjen e mjeteve OJQ-ve dhe mediave për vitin 2019 dhe as mënyrën e ndarjes së këtyre mjeteve.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Plavës


25
pikë

PLEVLË

www.pljevlja.me

Komuna e Plevlës, me 43 pikë nga 100 të mundshme, radhitet në mesin e komunave me transparencë të mesme.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 11; Buxheti – 8; Lufta kundër korrupsionit – 4; Qasja e informatave – 9; Prokurimet publike – 7; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 4.



Grafiku 24: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Plevlës

Faqja e internetit e Komunës së Plevlës është e konceptuar qartë, me mjaft kategori të veçanta dhe, në aspektin teknik, e lehtë për përdorim, por kjo nuk ndiqet nga përmbajtja në të gjithë aspektet e analizuara në bazë të indikatorëve të përcaktuara me këtë hulumtim.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 informata/dokumente të kërkuara e të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e Kuvendit të Komunës, në faqen e internetit janë të publikuara shtatë. Këtu përfshihen vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), amendamentet e dorëzuara në aktet e shqyrtuara, arsyetimi i pjesërishëm i këtyre amendamenteve (1 pikë), rendi i ditës nga seanca e ardhshme plenare (2 pikë), lista e këshilltarëve (2 pikë), një pjesë e procesverbaleve nga seancat plenare (1 pikë), si dhe të dhënat për transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave në ndonjërin nga mediat lokale (1 pikë).

Në ueb faqen e Komunës së Plevlës nuk u publikuan rezultatet e votimit në seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019 dhe as votat individuale të këshilltarëve me kontaktet e këshilltarëve.

• BUXHETI

Në fushën e cila ka të bëjë me buxhetin, prej gjithsej 10 dokumente/informata të kërkuara, në faqen e internetit të kësaj Komune u publikuan pesë – Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), Raporti për realizimin e Buxhetit (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë), Informata se u mbajt shqyrtimi publik për Buxhetin e vitit 2019 (2 pikë) dhe Buxheti për vitin 2020 (1 pikë).

Në ueb faqe nuk ekziston arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, Raporti për shqyrtimin publik të mbajtur dhe ky Buxhet nuk ekziston as në formën e lexueshme mekanike (.xls ose .xlsx). Po ashtu, nuk u publikua Udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret dhe as informata se a u shqyrtua Llogaria Përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në pjesën e luftës kundër korrupsionit u regjistrua transparenca e dobët, sepse nga 14 dokumente/informata të kërkuara vetëm tre janë publikuar – një pjesë e Kodeksit Etik për të punësuarit (1 pikë), Informata për pagat e funksionarëve (1 pikë) dhe Raporti i pasurisë i Kryetarit të Komunës për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekziston informata mbi mekanizmat e denoncimit të dhe as opsioni që qytetarët dhe qytetaret ti denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljet e korrupsionit ligjit nga ana e shërbimeve lokale, ndërsa nuk janë të mundura as denoncimet anonime. Përveç këtyre, nuk u publikuan as raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara ose proceduara gjatë vitit 2019, Plani i Integritetit për periudhën 2018 – 2020 dhe Plani Lokal i Antikorrupsionit, por as raporti për realizimin e këtyre dy planeve. Në fund, nuk u publikuan as informatat për pagat e zyrtarëve dhe as kontakti i personit i cili i shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Në faqen e internetit të Komunës së Plevlës nga 15 informata/dokumente të kërkuara, mund të qaset lista e inspektorateve të Komunës, më saktësisht të Inspektoratit Komunal (1 pikë), kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë), Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Komunë (1 pikë), të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë (1 pikë), Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontakti i personit i cili merr vendimet në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Nuk ekzistojnë të dhënat për orarin e punës së vetëqeverisjes vendore dhe as të dhënat për të vepruarit në bazë të ankesave dhe vërejtjeve. Në ueb faqe nuk është

afishuar orari i pranimit tek kryetari i Komunës, nuk janë të publikuara të dhënat kontaktuese për kryetarët e bashkësive lokale, por as dokumentet si Plani Vjetor i Punës së Komunës, Raporti i Punës për vitin 2019 dhe Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës. Nuk ekzistojnë as të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë dhe regjistri i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata.

• PROKURIMET PUBLIKE

Në faqen e internetit të Komunës së Plevlës ekziston seksioni i përcaktuar për prokurimet publike (1 pikë), të dhënat për konkurset e shpallura për prokurimet publike (2 pikë), prokurimet publike të realizuara gjatë vitit 2019 (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë). Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 dhe Raporti për realizimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019 nuk u publikuan.

• SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE

Ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike që u mbajtën gjatë vitit 2019 (2 pikë) dhe u publikuan edhe konkurset për ndarjen e mjeteve për organizatat e shoqërisë civile për vitin 2019 (1 pikë) me vendimin për ndarjen e këtyre mjeteve (1 pikë). Mirëpo, nuk ekziston raporti i shqyrtimeve publike propozimet e subjekteve të interesuara dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre, si dhe të dhënat për konkurset dhe mjetet e ndara për mediat gjatë vitit 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm
për Komunën e Plevlës

43
pikë

PLUZHINË

www.pluzine.me

Komuna e Pluzhinës është ndër komunat më transparente në Mal të Zi, me 52 pikë nga 100 të mundshme, sipas indikatorëve të përcaktuara me këtë hulumtim.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 6, Buxheti – 10, Lufta kundër korrupsionit – 4, Qasja e informatave – 15, Prokurimet publike – 9, Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 8.



Grafiku 25: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Pluzhinës

Faqja e internetit e komunës së Pluzhinës nuk është moderne për nga ana teknike, mirëpo është e qartë dhe përmban informatat të cilat nuk i kanë disa nga komunat më të zhvilluara të cilët kanë investuar më shumë në ridizajnimin e ueb faqeve të veta. Mirëpo, ka mjaft hapësirë për përmirësim, posaçërisht në disa kategori të caktuara, siç është lufta kundër korrupsionit.

• KUVENDI I KOMUNËS

Në faqen e internetit të Komunës së Pluzhinës prej 10 dokumente të kërkuara u gjetën tre – vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës nga mbledhja e ardhshme (2 pikë) dhe regjistri i këshilltarëve (2 pikë).

Mirëpo, në faqen e internetit nuk u publikuan amendamentet e dorëzuara në aktet

e shqyrtuara, arsyetimet e amendamenteve të dorëzuara, rezultatet e votimit në seancat plenare gjatë vitit 2019 dhe informatat për votimin individual të këshilltarëve, kontaktet e këshilltarëve, procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe as të dhënat për transmetimin e seancave plenare në media lokale.

• BUXHETI

Nga gjithsej 10 dokumente të kërkuara në fushën e buxhetit, në faqen e internetit të Komunës së Plluzhinës janë gjashtë: Buxheti i vitit 2019 (2 pikë), Raporti mbi Zbatimin e Buxhetit (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik lidhur me Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë), Informata se u mbajt shqyrtimi publik lidhur me Buxhetin e vitit 2019 (2 pikë), Raporti nga shqyrtimi publik lidhur me Buxhetin për vitin 2019 (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekziston arsyetimi i Buxhetit dhe as Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik (.xls ose .xlsx), por është në formatin PDF. Po ashtu, nuk u publikua udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret dhe as informata për shqyrtimin ose jo të Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në aspektin e luftës kundër korrupsionit, prej 14 informata/dokumente të kërkuara vetëm dy janë të publikuara – Kodeksi Etik për të Punësuarit (2 pikë) dhe Raporti për pasurinë e kryetarit të Komunës për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqe nuk ekzistojnë informatat mbi mekanizmat e denoncimit të korrupsionit, opsionet që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë, përkatësisht shkeljet e ligjit, por as mundësia që këto denoncimet të bëhen në mënyrë anonime. Gjithashtu, nuk u publikua raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara apo të proceduara gjatë vitit 2019, as Plani i Integritetit me Planin Lokal të Antikorrupsionit dhe as raportet për zbatimin e tyre. Po ashtu, nuk u publikuan as informatat për pagat e zyrtarëve dhe funksionarëve dhe as kontakti i personit të emëruar për shqyrtimin e denoncimeve të sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Në pjesën që ka të bëjë me qasjen e informatave të përgjithshme, prej 15 informata/dokumente të kërkuara tetë janë të publikuara në faqen e internetit: orari i punës i vetëqeverisjes vendore (2 pikë), lista e inspektorateve të Komunës (1 pikë), kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë) dhe i kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë), Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës (1 pikë), të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë (1 pikë), Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë), regjistri i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontakti i personit i cili merr vendimet në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Nga ana tjetër, nuk u publikuan: të dhënat për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve, orari i pranimi tek kryetari i Komunës, Plani Vjetor i Punës së Komunës, Raporti për Punën e Komunës në vitin 2019, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës dhe të dhënat për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet publike.

• PROKURIMET PUBLIKE

Në faqen e internetit të Komunës së Plluzhinës ekziston seksioni i përcaktuar për prokurimet publike (1 pikë) me të dhënat për konkurset e shpallura për prokurimet publike (2 pikë), prokurimet publike të zbatuara në vitin 2019 (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë). Po ashtu, u publikua Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019, gjersa Raporti për Zbatimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019 nuk u publikua.

• SHPALLJET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE

Prej shtatë informata/dokumente që kanë të bëjnë me shqyrtimet publike dhe konkurset publike, në faqen e internetit të Komunës së Plluzhinës ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike të mnajtura gjatë vitit 2019 (2 pikë), Raportet nga shqyrtimet publike të cilët përmbajnë propozimet e subjekteve të interesuara (2 pikë) dhe Raportet nga shqyrtimet publike që përmbajnë arsyet për pranimin ose refuzimin e propozimeve (2 pikë). Në ueb faqe u publikua edhe konkursi për ndarjen e mjeteve organizatave të shoqërisë civile për vitin 2019 (1 pikë) me vendimin e ndarjes (1 pikë). Nuk ekzistojnë të dhënat për mjetet e ndara për media gjatë vitit 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Plluzhinës


52
pikë

PODGORICË

www.podgorica.me

Kryeqyteti Podgorica, me 58 pikë nga 100 të mundshme, në bazë të indikatorëve të këtij hulumtim, është një nga dy komunat më transparente në Mal të Zi.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës - 9; Buxheti - 12; Lufta kundër korrupsionit - 5; Qasja e informatave - 17; Prokurimet publike - 7; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike - 8.



Grafiku 26: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Podgoricës

Faqja e internetit e Kryeqytetit, Podgoricës, ka disa nën faqe dhe një sërë kategorish të ndryshme, është mjaft e qartë dhe ka përmbajtje të larmishme. Edhe pse Komuna e Podgoricës sipas indikatorëve është njëra nga dy komunat më transparente, ekzistojnë fushat të cilat për nga përmbajtja janë të paplota dhe duhet të përmirësohen.

• KUVENDI I KOMUNËS

Komuna e Podgoricës i bëri të qasshme gjashtë prej 10 informata/dokumente të kërkuara – vendimet të cilat i miratoi Kuvendi i Kryeqytetit (2 pikë), amendamentet e dorëzuara në aktet e shqyrtuara (2 pikë), arsyetimet e këtyre amendamenteve (1 pikë), lista e këshilltarëve (2 pikë), procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Kryeqytetit (1 pikë) dhe Informata për transmetimin e drejtpërdrejtë në mediat lokale (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekziston rendi i ditës i seancës së ardhshme plenare të Kuvendit të Kryeqytetit, rezultatet e votimit në seancat plenare gjatë vitit 2019, informatat për votat individuale të këshilltarëve dhe kontaktet e këshilltarëve.

• BUXHETI

Nga gjithsej 10 dokumente të kërkuara në fushën e buxhetit, në faqen e Kryeqytetit janë gjithsej shtatë. Këtu hynë Buxheti për vitin 2019 (2 pikë), arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019 (1 pikë), Raporti për realizimin e buxhetit (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik të Buxhetit për vitin 2019 (1 pikë), Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët dhe Qytetaret (1 pikë), Informata se u mbajt shqyrtimi publik i Buxhetit të vitit 2019 (2 pikë), Raporti nga shqyrtimi publik i Buxhetit 2019 (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk u gjetën Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik (.xls ose .xlsx) dhe as informata se a u shqyrtua Llogaria Përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në pjesën e luftës kundër korrupsionit, në faqen e Kryeqytetit gjenden vetëm tre nga 14 informata/dokumente të kërkuara – opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljen e ligjit nga ana e shërbimeve lokale (2 pikë), Kodeksi Etik për të Punësuarit (1 pikë) dhe Plani Lokal i Antikorrupsionit për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk u publikuan: mekanizmat për denoncimin anonim të korrupsionit, raporti ose informata mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara ose proceduara gjatë vitit 2019, Plani i Integritetit për periudhën 2018-2020, raporti për zbatimin e Planit të Integritetit dhe Planit Lokal të Antikorrupsionit për vitin 2019, Informatat për pagat e zyrtarëve dhe funksionarëve dhe kontakti i personit i cili u emërua për të shqyrtuar denoncimet e Sinjalizuesve. Deri në përfundimin e këtij hulumtimi, në faqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit nuk ishte i publikuar Raporti i pasurisë i kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2019.

• QASJA E INFORMATAVE

Faqja e internetit e Kryeqytetit ka 10 nga gjithsej 15 informata/dokumente të kërkuara e që kanë karakter të përgjithshëm. Këtu përfshihen: lista e inspektorateve të Kryeqytetit, në kuptimin e Inspektoratit Komunal dhe Policisë Komunale (1 pikë), të dhënat për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve (2 pikë), kontakti i kryetarit të Kryeqytetit (2 pikë) dhe kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë) Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës (1 pikë), Planin Strategjik të Zhvillimit (2 pikë), Planin Vjetor të Punës (1 pikë), të dhënat për numrin e të punësuarve (1 pikë), Udhëzuesin për Qasjen e Lirë në Informata (1 pikë), pasqyrimi i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontakti i personit që merr vendimet në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Në ueb faqe nuk u publikuan: orari i punës së vetëqeverisjes vendore, orari i pranimit tek kryetari i Kryeqytetit, Raporti i Punës për vitin 2019 dhe as të dhënat për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet e Kryeqytetit, Podgoricës.

• PROKURIMET PUBLIKE

Në faqen e Komunës së Podgoricës ekziston seksioni i përcaktuar për prokurimet publike (1 pikë), me të dhënat për konkurset e prokurimeve publike (2 pikë), prokurimet publike të zbatuara në vitin 2019 (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë). Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 dhe Raporti për Zbatimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019 nuk u publikuan.

• SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE

Prej shtatë informatash/dokumenteve të cilët kanë të bëjnë me shqyrtimet publike dhe konkurset publike, ekzistojnë të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara gjatë vitit 2019 (2 pikë), raportet nga shqyrtimet publike të cilët përmbajnë propozimet e subjekteve të interesuara (2 pikë) dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve (2 pikë). Në faqe u publikuan edhe konkurset për ndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare për vitin 2019 (1 pikë) si dhe vendimi për ndarjen e mjeteve (1 pikë). Nuk ka të dhëna rreth konkurseve për media apo mjetet që iu ndanë mediave gjatë vitit 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Podgoricës




ROZHAJË

www.rozaje.me

Komuna e Rozhajës, me 25 nga 100 pikë të mundshme, të përcaktuara me indikatorët e këtij hulumtimi, gjendet në kategorinë e komunave më pak transparente në Mal të Zi.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës - 6; Buxheti - 2; Lufta kundër korrupsionit- 4; Qasja e informatave- 5; Prokurimet publike - 6; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike - 2.



Grafiku 27: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Rozhajës

Edhe pse, siç duket, faqja e internetit e Komunës së Rozhajës është punuar së fundmi, ajo nuk është e lehtë për përdoruesit dhe as nuk i qet në pah kategoritë të cilat mund t'ia lehtësojnë qytetarëve qasjen e informatave të nevojshme. Po ashtu, ato të cilët dëshirojnë që në mënyrë sistematike të përcjellin zbatimin e politikave publike kanë detyrë të vështirë, sepse disa kategori të zakonshme të informatave nuk gjenden as vizualisht dhe as në aspektin përmbajtjesorë.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 informata dhe dokumente të kërkuara në aspektin e transparencës së veprimtarisë të Kuvendit të Komunës, në faqen e Komunës së Rozhajës gjenden tre - vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës

i seancës së ardhshme plenare (2 pikë) dhe regjistri i këshilltarëve (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk u gjetën amendamentet në aktet e shqyrtuara, arsyetimet e amendamenteve të dorëzuara, rezultatet e votimit në seancat e Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019, votat individuale të këshilltarëve në vitin 2019, kontaktet e këshilltarëve, procesverbalet nga seancat e Kuvendit të Komunës dhe as informata se a transmetohen seancat plenare përmes mediave lokale.

• BUXHETI

Në fushën e çështjeve buxhetore u konstatua shkalla shqetësuese e jotransparencës. Nga 10 informata dhe dokumente të kërkuara, në faqen e internetit ishte vetëm Buxheti për vitin 2019.

Në faqen e internetit nuk u publikuan: arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik (.xls ose .xlsx), Thirrja publike për shqyrtimin publik të Buxhetit për vitin 2019, informata për mbajtjen e shqyrtimit publik për Buxhetin 2019, Raporti nga shqyrtimi publik i Buxhetit 2019, pastaj Buxheti i vitit 2020, informata se a u shqyrtua llogaria përfundimtare e buxhetit për vitin 2019, Raporti mbi Realizimin e Buxhetit për Vitin 2019 dhe as Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët dhe Qytetaret.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Sa i përket luftës kundër korrupsionit, nga 13 informata/dokumente të kërkuara, të publikuara ishin vetëm Kodeksi Etik për të punësuarit (2 pikë) dhe Raporti i pasurisë së kryetarit të Komunës për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekzistojnë këto të dhëna: mekanizmat për denoncimin e korrupsionit në Komunën e Rozhajës, opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljet e ligjit nga ana e shërbimeve lokale, mundësia e denoncimit anonim, raporti mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të proceduara gjatë vitit 2019, Plani i Integritetit, Plani Lokal i Antikorrupsionit, raportet për zbatimin e këtyre planeve, informatat për pagat e zyrtarëve dhe funksionarëve dhe kontaktet e personit të emëruar për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Faqja e internetit e Komunës së Rozhajës ka publikuar katër nga 15 informata/dokumente të përgjithshme, të kërkuara me këtë hulumtim – Udhëzuesin për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë), Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës (1 pikë), informatat e lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (1 pikë) dhe kontaktin e personit për zgjidhjen e kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Qytetarët dhe qytetaret nuk kanë qasje në: orarin e punës së vetëqeverisjes vendore, të dhënat për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve, të dhënat kontaktuese të kryetarëve të bashkësive lokale, lista e inspektorateve komunale, Plani Strategjik i

Zhvillimit të Komunës, Plani Vjetor i Punës, Raporti Vjetor i Punës së Komunës për vitin 2019, orari për pranimin tek kryetari i Komunës, si dhe të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë dhe në institucionet dhe ndërmarrjet publike.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Nga gjashtë informata/dokumente të kërkuara e që kanë të bëjnë me prokurimet publike, Komuna e Rozhajës ka publikuar tre. Në faqen e internetit ekziston seksioni për prokurimet publike (1 pikë), të dhënat për konkurset e publikuara për prokurimet publike (2 pikë) dhe prokurimet publike të realizuara gjatë vitit 2019 (2 pikë). Nga ana tjetër, Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë), Raporti për Zbatimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019 dhe të dhënat për ofertuesin e përzgjedhur nuk mund të gjenden në faqen e internetit të kësaj Komune.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Në fushën e shqyrtimeve publike dhe konkurseve publike, prej shtatë informata/dokumente të kërkuara e postuar ishte vetëm e dhëna për shqyrtimet e realizuara publike gjatë vitit 2019 (2 pikë). Nuk ekzistojnë raportet nga shqyrtimet publike, as të dhënat për propozimet e subjekteve të interesuara dhe as arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve. Po ashtu, nuk ka informata mbi konkurset për ndarjen e mjeteve organizatave të shoqërisë civile për vitin 2019 dhe as vendime për ndarjen e mjeteve, por as të dhëna për ndarjen e mjeteve mediave gjatë vitit 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Rozhajës


25
pikë

SHAVNIK

www.savnik.me

Komuna e Shavnikut me 30 pikë është në fundin e renditjes së komunave me transparencë të mesme.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si vijon: Kuvendi i Komunës – 6; Buxheti - 7; Lufta kundër korrupsionit - 2; Qasja e informative - 4; Prokurimet publike – 9; Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 2.



Grafiku 28: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Shavnikut

Faqja e internetit e Komunës së Shavnikut në pamje të parë është e qartë, por me shumë kategori që mungojnë dhe, akoma më e rëndësishme, me tejet pakë përmbajtje në formë informatash dhe dokumentesh me rëndësi për përcjelljen e punës së vetëqeverisjes vendore.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 dokumente/informata të kërkuara, e që kanë të bëjnë me Kuvendin e Komunës së Shavnikut, në faqen e internetit u publikuan vetëm tre – vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës i mbledhjes së ardhshme (2 pikë) dhe lista e këshilltarëve (2 pikë).

Në ueb faqe nuk u publikuan: rezultatet e votimit në seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019, votat individuale të këshilltarëve gjatë vitit 2019, kontaktet e këshilltarëve, amendamentet e dorëzuara gjatë shqyrtimit të akteve, arsyetimet e

amendamenteve të dorëzuara, procesverbalet nga seancat plenare dhe informatat rreth transmetimit të drejtpërdrejtë të seancave plenare në mediat lokale.

• BUXHETI

Nga 10 dokumente të kërkuara nga kategoria e buxhetit, në faqen e internetit të kësaj komune ekzistojnë pesë – Buxheti i vitit 2019 (2 pikë), Raporti për realizimin e buxhetit vetëm për tremujorin e parë (1 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik për Buxhetin e vitit 2019 (1 pikë), informata nga shqyrtimi publik i Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk u publikuan: arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019, Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik (.xls se .xlsx), udhëzuesi për qytetarët dhe qytetaret, informata se a u shqyrtua Llogaria Përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019 dhe Raporti mbi mbajtjen e shqyrtimit publik të Buxhetit të vitit 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Sa i përket informatave që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit, Komuna e Shavnikut fitoi vlerësimet më të dobëta. Nga 14 informata/dokumente të kërkuara ekziston vetëm raporti për pasurinë e kryetarit të Komunës për vitin 2019 (2 pikë), e i cili u publikua në faqen e internetit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Në faqen e internetit të Komunës së Shavnikut nuk u publikuan këto informata: mekanizmat për denoncimin e korrupsioni, opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljet e ligjit nga ana e shërbimeve vendore, mundësia për denoncim në formë anonime, raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara ose proceduara gjatë vitit 2019, Kodeksi Etik për të punësuarit, Plani i Integritetit për periudhën 2018-2020, Plani Lokal i Antikorrupsionit, raporti për realizimin e këtyre dy planeve, informatat për pagat e zyrtarëve dhe funksionarëve dhe kontakti i personit të emëruar për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Kur flasim për informatat me karakter të përgjithshëm, nga 15 informata/dokumente të kërkuara, mund të gjendet vetëm kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë) dhe kontakti i personit që shqyrton kërkesat për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Nga ana tjetër, informatat të cilat nuk u publikuan, e që janë të parapara me këtë kategori janë: orari i punës i vetëqeverisjes vendore, lista e inspektorateve të Komunës, të dhënat për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve, orari për pranimin tek kryetari i Komunës, të dhënat kontaktuese të kryetarëve të bashkësive lokale, Plani Vjetor i Punës së Komunës, Raporti i Punës i Komunës për vitin 2019, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës, të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë dhe në institucionet dhe ndërmarrjet publike, regjistri i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata, Rregullorja për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës dhe Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Shavnikut ekziston seksioni i përcaktuar për prokurimet publike (1 pikë) me të dhënat për konkurset e shpallura të prokurimeve publike (2 pikë), prokurimet publike të realizuara në vitin 2019 (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë). U publikua edhe Planit i Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë), mirëpo nuk ekziston Raporti për zbatimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Në këtë pjesë, në faqen e Komunës së Shavnikut, ekzistojnë vetëm të dhënat për shqyrtimet publike të realizuara gjatë vitit 2019 (2 pikë).

Nuk u publikuan raportet e shqyrtimeve publike të cilët përmbajnë propozimet e subjekteve të interesuara dhe as arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve. Po ashtu, nuk ekzistojnë të dhënat për konkurset ose mjetet e ndara për media gjatë vitit 2019, por as informatat për konkurset e ndarjes së mjeteve organizatave të shoqërisë civile për vitin 2019 dhe mënyrën e ndarjes së tyre.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Shavnikut




TIVAT

www.opstinativat.me

Komuna e Tivatit me gjithsej 56 pikë gjendet në majën e komunave malazeze për nga transparenca, gjegjësisht menjëherë pas sy komunave që ndajnë vendin e parë.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 8, Buxheti – 10, Lufta kundër korrupsionit – 4, Qasja e informatave – 17, Prokurimet publike – 9, Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 8.



Grafiku 29: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Tivatit

Faqja e internetit e Komunës së Tivatit është moderne, e qartë dhe funksionale. Përmban volume të mëdha të informacionit, mirëpo ka mundësi për përmirësimin e mëtejshëm, në veçanti sa i përket informatave dhe dokumenteve të cilët janë të rëndësishme për mbikëqyrjen e politikave publike, por edhe informimit të përgjithshëm të qytetarëve dhe qytetareve me punën e kësaj komunë.

• KUVENDI I KOMUNËS

Në këtë pjesë, nga 10 informata/dokumente të kërkuara, në faqen e Komunës së Tivatit u publikuan pesë – vendimet të cilat i miratoi Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës i seancave të ardhshme (2 pikë), lista e këshilltarëve (2 pikë), procesverbalet nga seancat e Kuvendit të Komunës (1 pikë), si dhe informata

se a transmetohen seancat plenare të Kuvendit të Komunës në mediat lokale (1 pikë).

Mirëpo, në faqen e internetit të Komunës së Tivatit nuk u publikuan amendamentet në aktet e shqyrtuara, arsyetimet e amendamenteve të dorëzuara, rezultatet e votimit nga seancat e Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019 dhe as votat individuale të këshilltarëve gjatë vitit 2019 me kontaktet e këshilltarëve.

• BUXHETI

Nga gjithsej 10 dokumente të kërkuara në kategorinë që ka të bëjë me buxhetin, në faqen e internetit ekzistojnë gjashtë: Buxheti i vitit 2019 (2 pikë), Raporti për Realizimin e Buxhetit të vitit 2019 (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik të Buxhetit për vitin 2019 (1 pikë), Informata për organizimin e shqyrtimit publik të Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë), Raporti mbi mbajtjen e shqyrtimit publik të Buxhetit të vitit 2019 (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë).

Në ueb faqe nuk u publikua arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019 dhe as Buxheti në formatin e lexueshëm mekanik (.xls dhe .xlsx). Qytetarët dhe qytetaret nuk kanë qasje në Udhëzuesin për Buxhetin dhe as në informatën se a shqyrtua Llogaria Përfundimtare e Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në pjesën e cila ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit, nga 14 informata/dokumente të kërkuara, në faqen e internetit u postuan vetëm informata mbi mekanizmat e denoncimit anonim të korrupsionit (2 pikë) dhe opsioni që qytetarët dhe qytetaret të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljet e ligjit përmes sistemit 48h (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk u publikuan: raporti ose informata për numrin e denoncimeve të dorëzuara ose të proceduara gjatë vitit 2019, Kodeksi Etik për të punësuarit, Plani Lokal i Antikorrupsionit për vitin 2019, Plani i Integritetit për periudhën 2018-2020, raportet për zbatimin e këtyre planeve, informatat për pagat e zyrtarëve dhe funksionarëve, kontakti i personit i cili shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve, ndërsa deri në përmbylljen e këtij hulumtimi në faqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit nuk u publikua raporti i pasurisë së kryetarit të Komunës për vitin 2019.

• QASJA E INFORMATAVE

Në faqen e internetit të Komunës së Tivatit gjenden 10 nga 15 informata/dokumente të përgjithshme: kontakti i kryetarit të Komunës (2 pikë), kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale (2 pikë), lista e inspektorateve të Komunës (2 pikë), Rregullorja për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës (1 pikë), Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës së Tivatit (2 pikë), Plani Vjetor i Punës (1 pikë), të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë (1 pikë), Udhëzuesi për Qasjen e Lirë në Informata (1 pikë), regjistri i informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontakti i personit i cili merr vendimet në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Në ueb faqen zyrtare të Komunës së Tivatit nuk u afishua orari i punës i vetëqeverisjes vendore dhe as orari i pranimi tek kryetari i Komunës. Po ashtu, nuk ekzistojnë informatat për të vepruarit në bazë të ankesave dhe vërejtjeve, Raporti i Punës i Komunës së Tivatit për Vitin 2019, por as të dhënat për numrin e të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet e kësaj Komune.

• PROKURIMET PUBLIKE

Në kategorinë e prokurimeve publike u publikuan pothuajse të gjithë informatat/dokumentet e kërkuara: seksioni i përcaktuar për prokurimet publike (1 pikë), Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë), të dhënat për konkurset e shpallura për prokurimet publike gjatë vitit 2019 (2 pikë), të dhënat për prokurimet publike të realizuara (2 pikë) dhe ofertuesit e zgjedhur (2 pikë). Në faqen e internetit nuk ekziston vetëm Raporti për Zbatimin e Planit të Prokurimeve Publike për vitin 2019.

• SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE

Nga shtatë informata/dokumente të kërkuara që kanë të bëjnë me shqyrtimet dhe konkurset publike, u publikuan të dhënat për shqyrtimet publike të organizuara gjatë vitit 2019 (2 pikë), Raportet e Shqyrtimeve Publike të cilët përmbajnë të dhënat për propozimet e subjekteve të interesuara (2 pikë) me arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve (2 pikë), si dhe konkurset për ndarjen e mjeteve OJQ-ve për vitin 2019 (1 pikë) me mënyrën e ndarjes së këtyre mjeteve (1 pikë). Nuk ka të dhënat për konkurset ose mjetet e ndara për media gjatë vitit 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Tivatit


56
pikë

TUZ

www.tuzi.org.me

Komuna e Tuzit, me 38 pikë nga 100 të mundshme, radhitet në mesin e komunave me transparencë të mesme në raportin krahasues me komunat tjera në Malin e Zi.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 6, Buxheti – 9, Lufta kundër korrupsionit – 1, Qasja e informatave – 9, Prokurimet publike – 11, Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 2.



Grafiku 30: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Tuzit

Komuna e Tuzit ka faqen e internetit me koncept të qartë dhe lehtë për kërkim, mirëpo në aspektin përmbajtjesor ka nevojë për përmirësime serioze, në mënyrë që informatat e rëndësishme për qytetarët dhe qytetaret të bëhen të qasshme dhe të mundësohet përcjellja më efektive e politikave publike.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 dokumente të kërkuara që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Kuvendit të Komunës, të publikuara janë vetëm tre – vendimet të cilat gjatë vitit 2019 i miratoi Kuvendi i Komunës (2 pikë), rendi i ditës i seancës së ardhshme plenare (2 pikë) dhe regjistri i këshilltarëve (2 pikë).

Në faqen e internetit të Komunës së Tuzit nuk u publikuan amendamentet e dorëzuara në aktet e shqyrtuara, arsyetimet e amendamenteve të dorëzuara, rezultatet e votimeve në

seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019, por as votat individuale (krye për emër) të këshilltarëve. Po ashtu, nuk u publikuan as procesverbalet nga seancat plenare të Kuvendit të Komunës, kontaktet e këshilltarëve dhe informatat për transmetimin e seancave plenare në mediat lokale.

• BUXHETI

Në pjesën e administrimit buxhetor, në faqen e internetit të kësaj Komune u publikuan gjashtë dokumente – Buxheti i vitit 2019 (2 pikë), arsyetimi i Buxhetit për vitin 2019 (1 pikë), Buxheti në formatin mekanik të lexueshëm (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik të Buxhetit për vitin 2019 (1 pikë), informata se u mbajt shqyrtimi publik i Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë). Komuna e Tuzit është një nga komunat e rralla malazeze e cila e publikoi Buxhetin e vitit 2019 në formatin mekanik të lexueshëm (.xls ose .xlsx).

Mirëpo, në faqen e internetit nuk u publikuan informatat që kanë të bëjnë me shqyrtimin e Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit për vitin 2019, Udhëzuesin e Buxhetit për qytetarët dhe qytetaret dhe me Raportin nga shqyrtimi publik i Buxhetit për vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në kategorinë e cila ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit pothuajse nuk ka informata. Më saktësisht, nga 13 dokumente/informata të kërkuara u publikua vetëm informata për pagat e funksionarëve (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekziston: opsioni që qytetarët ose qytetaret të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljen e ligjit në veprimtarinë e shërbimeve vendore, mekanizmat për denoncimin anonim të korrupsionit, raporti ose informata mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara ose të procedura gjatë vitit 2019, Plani i Integritetit për periudhën 2018 – 2020, Plani Lokal i Antikorrupsionit për vitin 2019, raporti për zbatimin e këtyre dy planeve, informatat për pagat e zyrtarëve, kontakti i personit i cili shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve dhe Kodeksi Etik për të punësuarit. Deri në përmbylljen e këtij hulumtimi nuk ishte i qasshëm as raporti i pasurisë së kryetarit të Komunës.

• QASJA E INFORMATAVE

Faqja e internetit e Komunës së Tuzit ka pesë nga 15 informata/dokumente të përgjithshme – orarin e punës të vetëqeverisje vendore (2 pikë), listën e inspektorateve të Komunës (1 pikë), Udhëzuesin për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë), pasqyrimin e informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontaktin e personit i cili merr vendimet në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë).

Pjesë e përmbajtjes së faqes së internetit nuk është kontakti i kryetarit të Komunës dhe as kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale. Po ashtu, nuk u afishua orari i pranimit të qytetarëve dhe qytetareve tek kryetari i Komunës, ndërsa nuk u publikua informata për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve. Sa i përket dokumenteve, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës së Tuzit, Plani Vjetor i Punës së Komunës së Tuzit, Rregullorja për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Raporti i Punës së Komunës së Tuzit për Vitin

2019 nuk u publikuan në ueb faqen zyrtare të Komunës së Tuzit. Në fund duhet të cekim se nuk është e mundur qasja e të dhënave për numrin e të punësuarve në Komunë dhe në institucionet dhe ndërmarrjet publike ku themelues është Komuna.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Tuzit ekzistojnë të gjithë të dhënat e kërkuara në fushën e prokurimeve publike. Pra, ekziston seksioni i veçantë për prokurimet publike (1 pikë), ndërsa Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë) dhe Raporti për Zbatimin e Prokurimeve Publike për vitin 2019 (2 pikë) janë pjesë e ueb faqes zyrtare të Komunës së Tuzit. Po ashtu, qasja është e mundur edhe tek të dhënat për konkurset e shpallura të prokurimeve publike (2 pikë), prokurimet publike të realizuara në vitin 2019 (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë).

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Kur flasim për shqyrtimet publike dhe konkurset publike, ekziston vetëm një nga shtatë informatat e kërkuara – informata për shqyrtimet publike të mbajtura gjatë vitit 2019 (2 pikë). Mirëpo, nuk u publikuan raportet e shqyrtimeve publike të cilët përmbajnë të dhënat për propozimet e subjekteve të interesuara dhe as arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve, konkurset për ndarjen e mjeteve mediave dhe organizatave joqeveritareve për vitin 2019, por as informata për ndarjen e mjeteve këtyre dy subjekteve.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Tuzit




ULQIN

www.ul-gov.me

Komuna e Ulqinit, me 37 pikë, bënë pjesë në kategorinë e komunave malazeze me transparencë të mesme. Mirëpo, duhet theksuar se transparenca e përgjithshme është shumë e ulët.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 8, Buxheti – 6, Lufta kundër korrupsionit – 8, Qasja e informatave – 10, Prokurimet publike – 3, Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 2.



Grafiku 31: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Ulqinit

Faqja e internetit e Komunës së Ulqinit është në tre gjuhë (malazeze, shqipe dhe angleze), me pamje të qartë, mirëpo me mungesë dokumentesh dhe informatash që do të mundësonin kontrollin efikas të politikave publike dhe janë të nevojshme për qytetarët dhe qytetaret.

• KUVENDI I KOMUNËS

Nga 10 dokumente të kërkuara, e që janë pjesë e veprimtarisë së Kuvendit të Komunës, gjatë hulumtimit ishin të publikuar pesë – vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës nga seanca e ardhshme plenare (2 pikë), lista e këshilltarëve (2 pikë), procesverbalet nga seancat plenare të Kuvendit të Komunës (1 pikë) dhe informata mbi transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në mediat lokale (1 pikë).

Në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit nuk ekzistonin rezultatet e votimit në seancat plenare të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019, amendamentet e dorëzuara në aktet e shqyrtuara, arsyetimet e këtyre amendamenteve, votat individuale të këshilltarëve gjatë vitit 2019 dhe as kontaktet e këshilltarëve.

• BUXHETI

Në pjesën që ka të bëjë me buxhetin, nga 10 dokumente të kërkuara, në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit ishin të postuara katër – Buxhet për vitin 2019 (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik të Buxhetit për vitin 2019 (1 pikë), informata mbi shqyrtimin e mbajtur publik të Buxhetit për vitin 2019 (2 pikë) dhe Buxheti për vitin 2020 (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk ishin të publikuara këto të dhëna: arsyetimi i Buxhetit të vitit 2019, Raporti mbi Realizimin e Buxhetit të vitit 2019, Buxheti në formatin mekanik të lexueshëm (.xls ose .xlsx), Raporti mbi shqyrtimin e mbajtur publik për Buxhetin e vitit 2019, informata se a u shqyrtua Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të vitit 2019 dhe Udhëzuesi për Qytetarë për Buxhetin e Komunës së Ulqinit për Vitin 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në aspektin e luftës kundër korrupsionit, të dhënat janë tejet të mangëta. Nga 14 dokumente/informata të kërkuara, vetëm katër janë të publikuara. Në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit ekzistojnë: informata mbi mekanizmat për denoncimin e korrupsionit (2 pikë), opsioni që qytetarët dhe qytetarët të denoncojnë parregullsitë, gjegjësisht shkeljet e ligjit (2 pikë) dhe Plani i Integritetit për periudhën 2018 – 2020 (2 pikë). Në faqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit gjendet raporti i pasurisë së kryetarit të Komunës për vitin 2019 (2 pikë).

Në faqen e internetit nuk u publikua raporti ose informata mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të proceduara për vitin 2019, Raporti për Zbatimin e Planit të Integritetit, Plani Lokal i Antikorrupsionit dhe Raportet për zbatimin e këtyre dy planeve. Përveç këtyre, nuk u publikuan informatat mbi pagat e funksionarëve dhe zyrtarëve, Kodeksi Etik për të Punësuarit, e as kontakti i personit që shqyrton denoncimet e Sinjalizuesve.

• QASJA E INFORMATAVE

Në aspektin e qasshmërisë së përgjithshme të të dhënave, Komuna e Ulqinit nga 15 dokumente/informata të kërkuara, postoi 5 në faqen e vet të internetit: kontaktin e kryetarit të Komunës (2 pikë), Planin Strategjik të Zhvillimit të Komunës së Ulqinit (2 pikë), Udhëzuesin për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë), pasqyrën e informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontaktin e personit që merr vendime në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata.

Nuk u publikua orari i punës dhe as orari i pranimit të qytetarëve dhe qytetareve tek kryetari i Komunës. Po ashtu, nuk ekziston lista e inspektorateve të Komunës dhe as kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale. Në faqen e internetit nuk ka të dhëna për të vepruarit sipas ankesave dhe vërejtjeve, nuk u publikuan Plani Vjetor i Punës dhe Raporti Vjetor i

Punës, por as të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë dhe në institucionet dhe ndërmarrjet publike ku themelues është Komuna.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit ekziston seksioni për prokurimet publike (1 pikë) me të dhënat për konkurset e shpallura të prokurimeve publike (2 pikë). Mirëpo, nuk u publikua Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019, as informata mbi prokurimet publike të mbajtura gjatë vitit 2019 dhe mbi ofertuesin e zgjedhur, dhe as Raporti mbi Realizimin e Prokurimeve Publike gjatë vitit 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Nga shtatë informata të kërkuara në këtë segment, në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit ekziston vetëm informata mbi shqyrtimet publike të mbajtura gjatë vitit 2019 (2 pikë). Nuk ekzistojnë raportet nga shqyrtimet publike të cilët përmbajnë propozimet e subjekteve të interesuara me arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve. Po ashtu, nuk ka të dhëna mbi konkurset ose mjetet e ndara për media dhe organizatat joqeveritare në vitin 2019.

Vlerësimi i përgjithshëm
i Komunës së Ulqinit


37
pikë

ZHABJAK

www.zabljak.me

Komuna e Zhabjakut, sipas indikatorëve të këtij hulumtimi, ka 43 pikë dhe radhitet në kategorinë e komunave malazeze me transparencë të mesme.

Sipas fushave, ndarja e pikëve është si në vazhdim: Kuvendi i Komunës – 7, Buxheti – 11, Lufta kundër korrupsionit – 3, Qasja e informatave – 11, Prokurimet publike – 9, Shqyrtimet publike dhe konkurset publike – 2.



Grafiku 32: Vlerësimi sipas fushave i Komunës së Zhabjakut

Faqja e internetit e Komunës së Zhabjakut është e qartë, edhe pse ka nevojë për freskim vizual dhe teknik, ndërsa në aspektin përmbajtjesorë ka mangësi të konsiderueshme të informatave që nevojiten për mbikëqyrjen cilësore të punës së kësaj vetëqeverisje vendore.

• KUVENDI I KOMUNËS

Në pjesën e cila ka të bëjë me veprimtarinë e Kuvendit të Komunës, në faqen e internetit të Komunës së Zhabjakut u publikuan vendimet të cilët i miratoi Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2019 (2 pikë), rendi i ditës i seancave të ardhshme plenare (2 pikë), lista e këshilltarëve (2 pikë) dhe procesverbalet nga seancat plenare të Kuvendit të Komunës (1 pikë).

Mirëpo, skuadra hulumtuese nuk arriti të gjejë rezultatet e votimit nga seancat plenare të

Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2019, amendamentet e dorëzuara në aktet e shqyrtuara dhe as arsyetimet e këtyre amendamenteve. Po ashtu, nuk ka informata mbi votat individuale të këshilltarëve gjatë vitit 2019, as për transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në mediat lokale, ndërsa nuk u afishuan as kontaktet e këshilltarëve.

• BUXHETI

Në kategorinë e cila ka të bëjë me buxhetin, nga 10 informata/dokumente të kërkuara në faqen e internetit të Komunës së Zhabjakut janë shtatë: Buxheti i vitit 2019 (2 pikë), Buxheti në formatin mekanik të lexueshëm (2 pikë), Raporti për realizimin e Buxhetit (2 pikë), Thirrja publike për shqyrtimin publik të Buxhetit (1 pikë), informata se a u mbajt shqyrtimi publik (2 pikë), raporti i shqyrtimit të mbajtur publik (2 pikë) dhe Buxheti i vitit 2020 (1 pikë). Vlen të përmendet se Komuna e Zhabjakut është ndër komunat e rralla malazeze e cila e ka Buxhetin e vitit 2019 në formatin mekanik të lexueshëm (.xls dhe .xlsx).

Në faqen e internetit nuk ekziston arsyetimi i Buxhetit, udhëzuesi për qytetarët dhe qytetarët dhe as informata se a u shqyrtua Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të Vitit 2019.

• LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Kur bëhet fjalë për luftën kundër korrupsionit, ka mangësi të konsiderueshme të informatave. Prej 14 informata/dokumente të kërkuara, në faqen e internetit ekziston vetëm Plani i Integritetit (2 pikë) dhe informata mbi pagat e funksionarëve (1 pikë).

Në faqen e internetit nuk ekzistojnë 12 informata/dokumente nga kjo kategori, e ato janë: Kodeksi Etik për të punësuarit, Raporti mbi Realizimin e Planit të Integritetit, Plani Lokal i Antikorrupsionit dhe raporti mbi zbatimin e tij, informata mbi mekanizmat për denoncimin e korrupsionit, opsionet e denoncimit të parregullsisë, gjegjësisht shkeljeve të ligjit dhe mundësia e denoncimit anonim, raporti mbi numrin e denoncimeve të dorëzuara dhe të procedura gjatë vitit 2019, informata mbi pagat e zyrtarëve dhe kontakti i personit të emëruar për shqyrtimin e denoncimeve të Sinjalizuesve. Deri në momentin e mbylljes së këtij hulumtimi, nuk ishte i publikua raporti i pasurisë i kryetarit të Komunës për vitin 2019.

• QASJA E INFORMATAVE

Komuna e Zhabjakut e publikoi kontaktin e kryetarit të Komunës (2 pikë), Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës (1 pikë), Planin Strategji të Zhvillimit (2 pikë) dhe Planin Vjetor të Punës (1 pikë) Udhëzuesin për Qasjen e Lirë të Informatave (2 pikë), pasqyrën e informatave të lejuara në bazë të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informata (2 pikë) dhe kontaktin e personit i cili merr vendime në bazë të kërkesave për qasjen e lirë në informata (2 pikë)

Nga ana tjetër, në kuadër të informatave të përgjithshme, nuk u publikua orari i punës i vetëqeverisjes vendore dhe as orari i pranimeve tek kryetari i Komunës. Po ashtu, nuk u afishuan kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale, e as lista e inspektorateve të komunës, por as të dhënat për të vepruarit në bazë të ankesave dhe vërejtjeve. Në faqe

nuk u postuan as Plani Vjetor i Punës me Raportin Vjetor të Punës për vitin 2019, por as të dhënat për numrin e të punësuarve në Komunë dhe në institucionet dhe ndërmarrjet e saja publike.

- **PROKURIMET PUBLIKE**

Në faqen e internetit të Komunës së Zhabjakut ekziston sekseioni i përcaktuar për prokurime publike (1 pikë) me Planin e Prokurimeve publike për vitin 2019 (2 pikë), të dhënat për konkurset e shpallura për prokurimet publike (2 pikë), prokurimet publike të mbajtura gjatë vitit 2019 (2 pikë) dhe ofertuesin e përzgjedhur (2 pikë). Vetëm, nga gjashtë dokumente të kërkuara, mungon Plani i Prokurimeve Publike për vitin 2019.

- **SHQYRTIMET PUBLIKE DHE KONKURSET PUBLIKE**

Në këtë fushë ekzistojnë vetëm konkurset për ndarjen e mjeteve organizatave të shoqërisë çivie për vitin 2019 (1 pikë) dhe vendimi përcjellës për ndarjen e këtyre mjeteve (1 pikë). Nuk ka të dhëna për shqyrtimet publike të mbajtura gjatë vitit 2019 (përveç për buxhet), raporti nga shqyrtimet publike me propozimet e subjekteve të interesuara me arsyet për pranimin ose refuzimin e këtyre propozimeve, por as të dhënat për konkurset dhe mjetet e ndara mediave.

Vlerësimi i përgjithshëm i
Komunës së Zhabjakut

43
pikë


KORRUPSIONI NË MAL TË ZI PËRMES PERCEPTIMIT TË QYTETARËVE DHE QYTETAREVE

Për nevojat e krijimit të pasqyrës më të qartë rreth çështjes së korrupsionit dhe analizës së perceptimeve të pranishme, është bërë hulumtimi i opinionit publik në terren nga agjencia IPSOS Strategic marketing duke përdorë teknikën e mostrës treshtresore të rëndomtë prej 1060 qytetarë dhe qytetare të moshës madhore më Mal të Zi. Hulumtimi u realizua në 17 qytete në Mal të Zi, përfshiu 130 territore të vendotimeve, gjegjësisht zonat në qytet, periferi dhe ato rurale. Grumbullimi i të dhënave në terren është bërë prej më 29 shkurt deri me 7 mars të vitit 2020. Meqë hulumtimi i ngjashëm është bërë edhe në vitin 2017, në kuadër të projektit të mëparshëm të Qendrës për Arsimim Qytetarë (QAQ) mbi korrupsionin në nivel vendor, u krahasuan të dhënat për të kuptuar tendencat dhe oscilimet e perceptimit të qytetarëve dhe qytetareve.

Perceptimi i përgjithshëm i korrupsionit dhe i korraktivitetit të institucioneve


Qytetarët dhe qytetaret e Malit të Zi njohin forma të ndryshme të korrupsionit, e në masë të madhe korrupsionin e lidhin me ryshfet, gjegjësisht me dhënien dhe marrjen e parave dhe dhuratave për ndonjë shërbim. Po ashtu, një pjesë e tyre i vlerësojnë keqpërdorimin e pozitës, plaçkitjen dhe punësimin me lidhje si praktika korruptive, ndërsa disa të tjerë me korrupsion shpjegojnë gjendjen e përgjithshme në shoqëri.

Madje 89% e qytetareve dhe qytetarëve konsiderojnë se dhënia e ryshfetit profesorit dhe policit është praktikë korruptive, pastaj vijon dhënia e ryshfetit punëtorëve administrativ dhe doktorëve dhe punësimi i kuadrove mbi baza partiake. Shfrytëzimi i njohjeve për tërheqjen e ndonjë dokumenti është trajta më pak e njohur e korrupsionit (69%), ndërsa në perceptimin e kësaj forme të korrupsionit regjistrohet edhe ndryshimi më i madh, më saktësisht rënia në krahasim me qëndrimet e opinionit publik para tre viteve.




Grafiku 33: Dallimi i formave të pranishme të korrupsionit

Në veçanti brengos fakti se madje 75% e qytetarëve dhe qytetareve të Malit të Zi e shohin korrupsionin si pjesë të përditshmërisë, ndërsa sipas mendimit të gjysmës së qytetarëve dhe qytetareve kjo mund të ndryshojë me anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe me rritjen e pagave të zyrtarëve. Edhe pse 69% deklarojnë se përgjegjësia për ryshfete është e dyanshme, një e treta arsyetojnë korrupsionin në disa raste.



Grafiku 34: Pajtimi me mendimet e caktuara rreth korrupsionit

Një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve dhe qytetareve mendojnë se korrupsioni është i pranishëm në institucione, si rrjedhojë asnjë institucion malazez nuk e gëzon besimin e tyre të madh. Dy të tretat e të anketuarve konsideron se korrupsioni është i pranishëm në institucionet shëndetësore dhe në partitë politike. Brengosin rezultatet edhe për Drejtorinë e Punëve Inspektuese, Drejtorinë e Doganave dhe Drejtorinë e Policisë (65%), pastaj për Prokurorinë, Drejtorinë e Tatimeve dhe mediave (61%), si dhe për gjyqësorin (60%). Është interesante informata se perceptimi i ekzistencës së korrupsionit në Drejtorinë Tatimore ra nga 66% në vitin 2017 në 61% në vitin 2020, në veçanti duke marrë parasysh ngjarjet e kohëve të fundit në rastin "Klap", kur u arrestuan disa zyrtarë të Drejtorisë Tatimore për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale nga fusha e korrupsionit. Në krahasim me vitin 2017, organet e vetëqeverisjes vendore kanë rezultate diçka më të mira. Para tre vitesh përqindja e atyre që mendonin se vetëqeverisjet vendore janë të korruptuara ishte 65%, ndërsa në vitin 2020 është 56%.




Grafiku 35: Perceptimi i korruptivitetit të institucioneve

Kur bëhet fjalë për korrupsivitetin personal, qytetarët dhe qytetaret e Malit të Zi, kryesisht, thonë se nuk janë të gatshëm të paguajnë ryshfet nëse do iu kërkonte dikush nga institucionet shtetërore, gjegjësisht vetëm 9% e tyre pranojnë se do të paguanin ryshfet, gjersa diçka më shumë se çereku deklarojnë se rastin do ta denonconin pranë institucionit kompetent. Po ashtu, pothuajse çereku i të anketuarve nuk do të ndërmarrë asnjëfarë mase.


Korrupsioni në nivel vendor dhe shtetëror

Numri më i madh i të anketuarve konsideron se korrupsioni është barabar i pranishëm në nivelin vendor dhe atë shtetëror, ndërsa forma dominuese e manifestimit të tij është kur zyrtarët pranojnë dhurata për të zgjidhur ndonjë problem privat. Në krahasim me hulumtimin para tre vitesh, korrupsioni në nivel vendor vërehet në masën mjaft më të vogël.



Grafiku 36: Njohja e praktikave korruptive në nivel vendor dhe shtetëror

Kur është fjala për lidhjet partiake, pothuajse 60% e qytetarëve dhe qytetareve konsiderojnë se nuk ka diferenca në mes nivelit vendor dhe atij shtetëror. Mirëpo, në krahasim me valën paraprake, më tepër qytetarë dhe qytetare konsiderojnë se lidhjet partiake shfrytëzohen më shumë në nivel shtetëror se në atë vendor, gjersa janë më pak të atillë që mendojnë të anasjellën dhe të atillë që deklarojnë se nuk ka dallim.



Grafiku 37: Ndikimi i lidhjeve partiake në zgjidhjen e probleme në nivel vendor dhe shtetëror

Shpeshtësia e praktikave korruptive

Sa i përket eksperiencës së ballafaqimit me korrupsionit, rreth një e katërta e qytetarëve dhe qytetareve deklaroi se dinë ose kanë dëgjuar për disa raste të dhënies së ryshfetit në rrethinën e tyre, ndërsa diçka më pak janë ato që dëgjuan vetëm për një rast të tillë. Tek ato që dinë ose kanë dëgjuar vetëm për një rast të korrupsionit, më së shpeshti bëhej fjalë për dhënien e parave ndonjë zyrtarit, gjersa tek qytetarët dhe qytetaret të cilët dinë për disa raste të korrupsionit më shpesh u theksua dhënia e dhuratave.

Pjesa më e madhe e qytetarëve dhe qytetareve (71%) nuk dinë asnjë rast të denoncuar të korrupsionit, në vendbanimin e tyre, i cili u mbyll në favorin e të dëmtuarit. Edhe pse kjo përqindje është më e ulët se në vitin 2017 (80%), ajo vazhdon të mbajë nivele brengosëse.

Sipas qytetarëve dhe qytetareve ndër arsyet kryesore të marrjes dhe dhënies së ryshfetit janë mungesa e gjobave dhe pagat e ulëta, si dhe vështirësia e marrjes së shërbimeve të nevojshme nëse ndjekim rrugën e rregullt. Është me rëndësi të theksohet se arsyet e kësaj janë joefikasiteti i organeve të specializuara për luftë kundër korrupsionit, por edhe mungesa e vetëdijes për dëmin e korrupsionit.

Njohja e dokumenteve dhe pozitave të institucione kompetente në luftën kundër korrupsionit

Vazhdon të mbetet e lartë përqindja e qytetarëve dhe qytetareve të cilët nuk janë të informuar në mënyrë adekuate për dispozitat dhe dokumentet me të cilët u rregullua lëmia e luftës kundër korrupsionit. Pjesa më e madhe e tyre (66%) janë të njoftuar me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit. Në pamje të parë kjo mund të perceptohet si pozitive, por duhet të rikujtojmë se përqindja e njëjtë u regjistrua edhe në vitin 2017

që do të thotë se nuk ka përparime, e nuk duhet të shpërfillet fakti se çereku i të anketuarve nuk ka dëgjuar për këtë ligj. Gjithashtu, vetëm gjysma e të anketuarve thonë se kanë dëgjuar për Kodin Penal, që është konsiderueshëm më pak në raport me valën paraprake nga viti 2017, kur kjo përqindje ishte në nivelin 65%.

Në kuadër të hulumtimit, janë përfshirë edhe qëndrimet ndaj disa institucione kyçe për eliminimin e korrupsionit – Agjencinë për Parandalim Korrupsionit (APK), Prokurorinë Speciale Shtetërore (PSSH) dhe Institucionin Shtetëror të Auditit (ISHA).


As pas katër vitesh nga krijimi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, qytetarët dhe qytetaret nuk janë mjaftueshëm të informuar për këtë institucion. Kështu për APK dëgjuan tre çerek të të anketuarve, mirëpo dy të pestat nuk dinë mjaftueshëm për kompetencat dhe punën e APK-së. Për shembull, 48% e të anketuarve mendojnë se ndjekja penale e rasteve të korrupsionit është aktivitet i APK-së, që është gabim. Nivel të ngjashëm me valën e mëparshme nga viti 2017, mban përqindja e atyre të cilët e konsiderojnë preventimin dhe edukimin në lëminë e luftës kundër korrupsionit aktivitet të APK-së. Ajo që brengos në veçanti është që vetëm 5% e të anketuarve në vitin 2020 e numërojnë mbrojtjen e Sinjalizuesve si aktivitet të Agjencisë, gjersa në vitin 2017 15% e tyre mendonte se APK-ja ia siguron mbrojtje Sinjalizuesve. Në fund, për tre vite nuk ka rritje të konsiderueshme në perceptimin pozitiv të punës së APK-së (15%), u zvogëlua edhe numri i atyre që kanë qëndrim neutral (18%) dhe negativ (32%), gjersa u trefishua numri i atyre që nuk dëshirojnë të shprehin mendimin personal lidhur me APK-në (35%).

Puna e Prokurorisë Speciale Shtetërore në luftën kundër korrupsionit vlerësohet si negative nga 42% e qytetarëve dhe qytetareve, 23% janë neutral, ndërsa nga 17% vlerësohet si pozitive. Edhe tek ky institucion, në krahasim me të dhënat nga vala paraprake gjatë vitit 2017, u regjistrua numër diçka më i vogël i qytetarëve dhe qytetarëve të cilët kanë raport negativ dhe neutral, me një rritje të caktuar të atyre që janë të papërcaktuar.

Shumica e të anketuarve janë të pakënaqur me punën e ISHA-së, gjegjësisht 39% e tyre e vlerësojnë negativisht punën e këtij institucioni, vetëm 17% kanë qëndrim pozitiv, ndërsa 22% janë neutral në raport me punën e ISHA-së, që është përqindje pothuajse e njëjtë me të papërcaktuarit.

Denoncimi i korrupsionit


Qytetarët kanë mendime të ndara rreth denoncimit ose jo të korrupsionit, me 41% të atyre që do ta denonconin korrupsionin dhe 40% të atyre që nuk do ta bënin një gjë të tillë, gjersa pothuajse një e pesta janë të papërcaktuar. Në raport me hulumtimin e vitit 2017, regjistrohet rënia e atyre që do ta denonconin korrupsionin, ndërsa rritet numri i të papërcaktuarve.



Grafiku 38: Denoncimi i korrupsionit

Në rastin e denoncimit anonim të korrupsionit, situata është pak më e mirë dhe 47% e qytetarëve dhe qytetareve do t'i informonin organet kompetente në mënyrë anonime, ndërsa 38% nuk do ta denonconin korrupsionin as atëherë. Në këtë rast të papërcaktuar janë 15%.

Sipas përgjigjeve më të shpeshta të qytetarëve dhe qytetareve, APK dhe Drejtoria e Policisë janë institucionet e para ku ato do të denonconin rastin e korrupsionit, pastaj vijnë organizatat joqeveritare dhe mediat. Për dallim nga viti 2017, përqindja e atyre që do ta denonconin korrupsionin pranë APK-së është rrit lehtë, ndërsa ka rënë konsiderueshëm numri i qytetarëve dhe qytetareve të cilët do ta denonconin korrupsionin në Drejtorinë e Policisë (nga 41% në 34%).




Grafiku 39: Institucionet e para ku qytetarët dhe qytetaret do ta denonconin korrupsionin

Numri më i madh i qytetarëve dhe qytetareve të cilët nuk do ta denonconin korrupsionin (28%) mendojnë se arsyeja kryesore për këtë përcaktim të tyre është se

puna e shtetit është të zbulojë korrupsionin, gjersa pothuajse një çerek u përgjigj se nuk e beson se ky denoncim do të kishte efekt ose se kanë frikë sigurinë personale. Çdo i dhjeti i anketuar konsideron se korrupsioni është njëra nga mënyrat që njerëzit përdorin për të mbijetuar, prandaj nuk do ta denonconin korrupsionin.


Nivelet e korrupsionit dhe zgjidhja e tij

Në pyetjen se a është problem më i madh korrupsioni në nivelin e lartë (në majat politike dhe ekonomike) apo korrupsioni në nivelet më të ulëta, i cili zhvillohet në spitale, shkolla, gjatë kontaktit me zyrtarët policor dhe/ose të tjerë shtetëror, 42% e qytetarëve dhe qytetareve mendojnë se të dy nivelet e korrupsionit janë barabar problematik, gjersa 30% konsiderojnë se korrupsioni i cili zhvillohet në nivelet e larta është problem më i madh, ndërsa vetëm 14% e shohin si problem më të madh në nivelet e ulëta. Në krahasim me vitin 2017, përqindja e atyre të cilët e konsiderojnë si problem të barabartë në Mal të Zi korrupsionin në nivele të larta dhe korrupsionin në nivele të ulëta është shumë më i ulët.



Grafiku 40: Renditja e problematikës së korrupsionit në nivelet e larta dhe të ulëta


Për dallim nga viti 2017, në masë të konsiderueshme ra përqindja e qytetarëve dhe qytetareve të cilët konsiderojnë se ekzistojnë mekanizmat efikase për zgjidhjen e problemit të korrupsionit, edhe pse dënimet më rigorozë ligjore dhe zbatimi i drejtë i ligjit vazhdojnë të pozicionohen lartë në renditje. Mirëpo, derisa në vitin 2017 tre të katërtat e të anketuarve deklarorin se dënimet më të rrepta ligjore janë mënyra më e suksesshme për zgjidhjen e problemit të korrupsionit, sot këtë e besojnë diçka më shumë se gjysma e qytetarëve dhe qytetareve. Numri i atyre që konsiderojnë se problemi i korrupsionit mund të zgjidhet me zbatimin e drejtë të ligjit është shumë më i vogël, gjegjësisht kjo përqindje nga dy të tretat siç ishte dikur ra në më pak se gjysma e të anketuarve. Regjistrohet rënia e ngjashme e besimit në fuqinë e mekanizmave të tjerë, siç janë rritja e pagave, fuqizimi i vetëdijes për dëmin e korrupsionit, kontrolli më i madh i organeve publike nga ana e OJQ-ve, etj.



Grafiku 41: Masat për zgjidhjen e korrupsionit

Përgjegjësia dhe transparenca e Komunave

Qytetarët kanë mendime të ndara për përgjegjësinë e udhëheqësve vendor në komunat ku jetojnë. Rreth dy të pestat e të anketuarve mendojnë se udhëheqësit e administratës së Komunës sillen në mënyrë të përgjegjshme, e diçka më pak janë ato që kanë mendim të kundërt.




Në ç'masë drejtuesit e administratës vendore të komunës ku jetoni sillen në mënyrë të përgjegjshme ndaj qytetarëve dhe ndaj interesit publik?

Baza: Popullata target

Të dhënat janë në %

Grafiku 42: Përgjegjësia e drejtuesve të administratës vendore

Më shumë se dy të pestat e qytetarëve dhe qytetareve e vlerësojnë pozitivisht transparençën e Komunave në të cilat jetojnë, gjersa një e treta konsiderojnë se administrata e tyre vendore është jotransparente.



Sipas mendimit Tuaj, sa është transparente administrata vendore e komunës në të cilën jetoni? Në ç'masë mund të pajiseni lehtësisht me të gjithë dokumentet e nevojshme përmes faqes së internetit , përmes kontaktit me shërbimet e Komunës, etj?

Baza: Popullata target

Të dhënat në %

Grafiku 43: Transparenca e Komunave

Gjatë vlerësimit të administratave vendore vërehet se qytetarët dhe qytetaret nga jugu i Malit të Zi kanë qëndrim shumë më të rreptë në raport me regjionin verior dhe atë qendror.

VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Nga 100 pikë të mundshme, sipas indikatorëve të hulumtimit të realizuar, vlerësimi mesatar i transparencës së Komunave malazeze për vitin 2019 është 40.76 pikë. Dy Komunat më transparente – Podgorica dhe Bijello pole – kanë diçka më pak se tre të pestat e pikëve të mundshme, gjegjësisht 58 pikë.

Nëse e vështrojmë transparencën e Komunave përmes gjendjes rajonale, atëherë zona jugore udhëheq me notën mesatare 43.40, pastaj vjen zona qendrore me 41.16, ndërsa në fund është zona veriore me 38.42 pikë.

Analiza e përgjithshme e Komunave ku pushtetin e ushtron koalicioni qeverisës në nivel shtetëror me komunat ku pushtetin e ushtrojnë partitë të cilët në nivel shtetëror janë opozitë është interesante sepse praktikisht nuk ka dallim për nga shkalla e transparencës. Mesatarja për Komunat e drejtuara nga opozita është 40.80, ndërsa për ato ku pushtetin e ushtron koalicioni qeverisës nga niveli shtetëror është 40.78 pikë.

Madhësia e Komunave dhe numri i banorëve nuk kanë ndikim të veçantë në shkallën e transparencës.

Asnjë Komunë në faqen e vet të internetit nuk i kishte këto informata/dokumente të kërkuara: votat individuale të këshilltarëve gjatë vitit 2019, Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit për vitin 2019, raportin ose informatën mbi numrin e denoncimeve për korrupsion, të dorëzuara ose procedura gjatë vitit 2019, raportet për zbatimin e Planit të Integritetit dhe Planin Lokal të Antikorrupsionit për vitin 2019, oraret e afishuara për pranimin e qytetarëve tek kryetari i Komunës, Raportin e Punës së vetëqeverisjes vendore për vitin 2019 dhe informatat për ndarjen e mjeteve financiare mediave.

Çështja e transparencës së Komunave, edhe pse e nënvlerësuar, është tejet e rëndësishme për eliminimin efikas të korrupsionit, por edhe për mbikëqyrjen e politikave publike në nivel vendor dhe përmirësimin e shërbimeve të cilët Komunat ia ofrojnë qytetarëve dhe qytetareve.

Indeksi i Transparencës së Komunave Malazeze mund të jetë udhëzues i mirë për ato Komuna të cilat dëshirojnë të përmirësojnë transparencën e vet për të gjithë subjektet e interesuara dhe matjet e ardhshme do të tregojnë nivelin e dedikimit të tyre për arritjen e këtij qëllimi.

